



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

MENAXHIMI I RREZIKUT NGA KATASTROFAT MANUAL PËR DEPUTETËT





ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTËTJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MENAXHIMI I RREZIKUT NGA KATASTROFAT

MANUAL PËR DEPUTETËT

Autor:
mr. Vasko Popovski

Implementuar nga:



Titulli: Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat: Manual për deputetët

Titulli i origjinalit: Управување со ризици од катастрофи – Прирачник за пратеници, përkthyer nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe - Florije Elezi

Botues: Instituti Nacional Demokratik për çështje ndërkombëtare- NDI Republika e Maqedonisë së Veriut

Për botuesin: Robert Scott Heaslet

Autorë: Vasko Popovski

Redaktorët e botimit: Ana Angelovska, Lidija Stojkova Zafirovska

Redaktor gjuhësor: Ismail Hamiti

Ilustrim për kopertinë: “vectorjuice / Freepik”

Përgatitja dhe shtypi: Digiprint

Tirazhi: 40

Shkup, 2024

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

005.52:005.334]:342.53(497.7)(035)
Ѓ14.8:342.53(497.7)(035)

POPOVSKI, Vasko

Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat : manual për deputetët / autor Vasko Popovski ; [përkthyer nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Florije Elezi]. - Shkup : Instituti nacional demokratik për çështje ndërkombëtare- NDI Republika e Maqedonisë së Veriut, 2024. - 36 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Управување со ризици од катастрофи : прирачник за пратеници. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 36. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-4921-16-5

а) Управување со кризи -- Улога на Собранието -- Македонија -- Прирачници

COBISS.MK-ID 63188485

Ky manual është përgatitur në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PSP zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (CUP).

Përmbajtja e kësaj analize në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron gjithmonë pikëpamjet e donatorit (SDC), dhe as të NDI, IDSCS apo CUP.

PARATHËNIE

Rritja e numrit të katastrofave, të shkaktuara nga rreziqe natyrore dhe nga njeriu, situatat e krizës, si pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19, pasojat e ndryshimeve klimatike, lëvizjet e migracionit, përqendrimi i gjendjes së mjedisit jetësor, kriza energjetike, paqëndrueshmëria gjeopolitike dhe të tjera, konfirmojnë nevojën e përfshirjes aktive të të gjitha palëve të interesuara në shoqëri, në uljen e rreziqeve ekzistuese dhe parandalimin e krijimit të rreziqeve të reja, si dhe në ndërtimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe komuniteteve lokale. Në fakt, për këtë, edhe Korniza nga Sendai për uljen e rrezikut nga katastrofat 2015-2030 e thekson nevojën për përfshirjen e të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjithëve në shoqëri. Më pas, theksohet nevoja që institucionet të parashikojnë, analizojnë, parandalojnë dhe përballojnë më mirë rreziqet dhe situatat e rrezikshme, deri sa të sigurohet qëndrueshmëria e funksioneve dhe sistemeve kritike shoqërore dhe të sigurohen shërbimet e nevojshme për qytetarët. Qasja transformuese ndaj menaxhimit të rrezikut nga katastrofat, prej **reaktiv**, i fokusuar vetëm në reagimin dhe kompetencat e një rrethi të ngushtë institucionesh, në **proaktiv**, ku fokusi është në parandalimin dhe zbutjen, dhe kompetencat e të gjitha institucioneve në pushtet (angl. *Whole of Government*) dhe të gjithëve në shoqëri (angl: *All of Society*), **përfshin edhe parlamentet, të cilat në nivel global kanë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie rezistente dhe të qëndrueshme.**

Pikërisht në këtë drejtim, edhe **Korniza nga Sendai për uljen e rrezikut nga katastrofat 2015-2030**¹ u bën thirrje deputetëve të mbështesin realizimin e uljes së rrezikut nga katastrofat, duke miratuar ose ndryshuar legjislacionin ekzistues, duke krijuar strategji nacionale për uljen e rrezikut nga katastrofat, duke rritur burimet financiare të buxheteve për uljen e rreziqeve dhe duke monitoruar përgjegjësinë e qeverive për të ulur rreziqet nga katastrofat.² Në këtë kontekst, u bën thirrje Unionit Ndërparlamentar dhe organeve dhe mekanizmave të tjerë relevantë rajonalë për parlamentarët, si më përkatës, të vazhdojnë në kontinuitet mbështetjen dhe lobimin për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe forcimin e kornizave ligjore nacionale.³ Nga ana tjetër, në vitin 2019, **Unioni Ndërparlamentar** miratoi një rezolutë ku u bën thirrje deputetëve të përfshijnë uljen e rrezikut nga katastrofat, në aktivitetet e tyre, për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rezistent.

Rrjedhimisht, në kontekstin nacional të menaxhimit të rrezikut nga katastrofat, rol të rëndësishëm ka edhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili si bartës i njërës prej tre pushteteve në vend, atë legjislativ, ka kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara. Në periudhën e kaluar Kuvendi ka pasur një rol të rëndësishëm në ndërtimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe komuniteteve lokale, në radhë të parë përmes realizimit të rolit legjislativ, rolit mbikëqyrës mbi sistemet ekzistuese, miratimit të Strategjisë Nacionale për Mbrojtje dhe Shpëtim, por edhe nëpërmjet përdorimit të mekanizmit për zgjatjen e gjendjeve të shpallura të krizës. Kuvendi luajti një rol të rëndësishëm gjatë krizës së parë të shpallur në vitin 2007 pas zjarreve të përhapura, që prekën pothuajse gjysmën e vendit dhe popullsisë, dhe krizën me migrantët dhe refugjatët nga viti 2015. Në një moment të caktuar, gjatë vitit 2021, njëkohësisht kishte të shpallura katër situata krize, gjegjësisht, përballimi me krizën me refugjatët në kufijtë veriorë dhe jugorë, përballimi me pandeminë COVID-19 dhe përballimi me zjarret në pjesën lindore gjatë verës. Megjithatë, në funksion të kornizave dhe mekanizmave bashkëkohorë për

¹ https://www.unisdr.org/files/43291_sendaiframeworkfordrren.pdf

² Korniza nga Sendai për uljen e rreziqeve nga katastrofat 2015 – 2030. Nenet 27 (e), (i), (h); 48 (h).

³ Korniza nga Sendai për uljen e rreziqeve nga katastrofat 2015 – 2030. Neni 48 (h).

zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent, këto kompetenca dhe aktivitete janë të pamjaftueshme dhe është i nevojshëm zgjerimi i tyre dhe ngritja e mëtejshme e kapaciteteve dhe njohurive të deputetëve dhe stafit të Kuvendit.

Përshkak të kësaj, qëllimi i këtij manuali është të forcojë rolin e Kuvendit në menaxhimin e rrezikut nga katastrofat, duke rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë, si dhe rolin e deputetëve në përmbushjen më të mirë të përgjegjësisë ekzistuese, si dhe përmes zbatimit më efikas dhe efektiv të mekanizmave ekzistues për mbikëqyrje. Ky manual shpjegon rëndësinë e zvogëlimin të rrezikut nga katastrofat, shpjegon detyrat kryesore në të cilat parlamentet kanë mundësi të kontribuojnë në zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat dhe rekomandon një listë me masa që deputetët mund t'i zbatojnë, të cilat janë përcaktuar sipas pesë fushave të përgjegjësisë së parlamenteve të UNDRR dhe IPU. Manuali është në përputhje me Kornizën nga Sendai, kornizën ekzistuese nacionale të politikave dhe legjislacionit, dhe ka për qëllim të ndihmojë deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, para krizave, gjatë dhe pas krizave dhe katastrofave, që praktikisht të zbatojnë aktivitete që do të kontribuojnë në zvogëlimin e rreziqeve, pasojat e këtyre ngjarjeve, si dhe për të marrë pjesë në miratimin e zgjidhjeve gjithëpërfshirëse për ndërtimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe komuniteteve. Në këtë kontekst, për disa nga pesë rolet, aktivitetet e mundshme janë renditur veçmas në tri faza d.m.th. para, gjatë dhe pas katastrofës, ndërsa në disa prej tyre, aktivitetet kryhen në mënyrë të njëpasnjëshme në tri faza.

Qasja dhe kuadri metodologjik është gjithëpërfshirës, duke përdorur një kombinim të mjeteve kualitative dhe kuantitative. Përgatitja e manualit për deputetët përfshinte *një analizë të përmbajtjes* (u përdor gjatë kohës së fazës fillestare, duke shqyrtuar dhe analizuar përmbajtjen e të gjitha dokumenteve, raporteve dhe informacioneve në dispozicion); *analiza krahasuese* (gjatë shqyrtimit të materialeve dhe dokumenteve në zyrë) dhe *dizajni kualitativ* (gjatë kohës së mbledhjes së informacionit dhe të dhënave nga informatorët kyç nëpërmjet përdorimit të intervistave gjysmë të strukturuar dhe konsultimeve me përfaqësues të grupeve parlamentare në Kuvend, gjegjësisht partitë politike VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, Aleanca për Shqiptarët, PDM dhe Lidhja Demokratike⁴, si dhe gjatë identifikimit dhe kodifikimit të mësimave të nxjerra dhe praktikave të mira).

⁴ Gjetjet dhe rekomandimet nga takimet konsultative me deputetët janë dhënë si shtojcë nr. 5 të këtij dokumenti

SHKURTESAT

VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas
DMSH	Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim
PDM	Përtëritja Demokratike e Maqedonisë
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
IDSCS	Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup
IPU	Unioni Ndërparlamentar
NDI	Instituti Nacional Demokratik
KB	Kombet e Bashkuara
PSP	Programi për Mbështetje Parlamentare
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
NJTZF	Njësia Territoriale e Zjarrfikësve
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNDRR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë
USD	Dollarë amerikanë
QZHQ	Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
QMK	Qendra për Menaxhim me Kriza
CUP	Qendra për Menaxhim me Ndryshimet

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
SHKURTESAT	5
1.HYRJJE	7
1.1 Cili është profili i rreziqeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut?	7
1.2 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe menaxhimi me rreziqet nga katastrofat	8
2.PARLAMENTET DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE NGA KATASTROFAT NË NIVEL GLOBAL	9
2.1 Informacione të përgjithshme	9
2.2. Kompetencat në të cilat parlamentet kanë mundësi të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga katastrofat	11
3. ROLI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË MENAXHIMIN E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT DHE AKTIVITETET E DEPUTETËVE	11
3.1. Hyrje	11
3.2 Kompetencat e përgjithshme dhe roli i deputetëve	12
3.3 Pesë kompetencat për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe roli i deputetëve	13
Shtojca 1 – TERMINOLOGJIA BAZË	25
Shtojca 2 – PARLAMENTET DHE ULJA E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT NË NIVEL GLOBAL (MË SHUMË INFORMACIONE MBI MEKANIZMAT GLOBAL)	27
Shtojca 3 - KORNIZA NACIONALË PËR ULJEN E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT DHE ROLI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	31
Shtojca 4 – LIGJET DHE AKTET NËNLIGJORE NGA FUSHA E ULJES SË RREZIQEVE NGA KATASTROFAT ...	33
Shtojca 5 – GJETJE DHE REKOMANDIME NGA TAKIMET KONSULTATIVE ME DEPUTETË	34
BIBLIOGRAFIJA	36

1. HYRJE

1.1. Cili është profili i rreziqeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

Profilin e rreziqeve në vend e përbëjnë një sërë rreziqesh natyrore si dhe ato të shkaktuara nga njeriu, duke përfshirë tërmetet, përmbytjet, zjarret, temperaturat ekstreme, stuhitë me breshër, rrëshqitjet e dheut, thatësitrat, epidemitë, aksidentet industriale të shkaktuara nga shpërthimet dhe shkaqe të tjera teknike, aksidente trafiku në rrugë, trafiku hekurudhor dhe ajror, aksidentet në miniera, derdhjet e naftës dhe derivateve të naftës dhe kimikateve të tjera toksike, shpërthimet e gazeve ose të lëngjeve ndezëse, etj.

- *Përmbytjet dominojnë* për sa i përket shpeshtësisë dhe pasojave për shoqërinë dhe komunitetet. Numri më i madh i viktimave njerëzore (22) kanë qenë rezultat i vërshimeve të rrëmbyeshme në zonën e Qytetit të Shkupit në gusht të vitit 2016, përmbytjet e vitit 1995 shkaktuan dëme prej 245 milionë dollarë, ndërsa përmbytjet gjatë vitit 2015 dhe 2016 kanë shkaktuar një dëm prej gjithsej 177 milionë USD).⁵
- *Zjarret pyjore* janë duke u rritur në shpeshtësi dhe me pasoja për natyrën dhe diversitetin biologjik (zjarret pyjore në verën e vitit 2007 kanë prekur pothuajse gjysmën e territorit dhe popullsisë së vendit dhe kanë kushtuar më shumë se 13 milionë euro⁶, *Zjarret pyjore* janë duke u rritur në shpeshtësi dhe me pasoja për natyrën dhe diversitetin biologjik (zjarret pyjore në verën e vitit 2007 kanë prekur pothuajse gjysmën e territorit dhe popullsisë së vendit dhe kanë kushtuar më shumë se 13 milionë euro⁷).
- *Ngjarjet e lidhura me kushtet e motit* janë në rritje me magnituda më të mëdha, ndërkohë që tërmetet kanë potencialisht ndikimin më të madh ndaj vendit dhe qytetarëve për sa i përket humbjeve të jetëve, dëmeve dhe humbjeve afatgjata (tërmeti i Shkupit nga vitit 1963 ka shkaktuar humbjen e 1070 njerëzve, 3300 njerëz janë plagosur ndërsa dëmi është vlerësuar në 5 miliardë dollarë, ndërsa tërmeti i shtatorit të vitit 2016 ka shkaktuar dëme prej 10 milionë dollarë⁸).

Nga ana tjetër, gjatë vitit ndodhin një numër i madh ngjarjesh me përmasa dhe pasoja më të vogla, por të njëjtit ndikojnë në mënyrë kronike në qëndrueshmërinë e shoqërisë dhe të komuniteteve lokale, duke shteruar burimet dhe kapacitetet e tyre të kufizuara. Ky trend pritet të vazhdojë me ritme të shtuara, duke marrë parasysh rritjen e temperaturës mesatare, pasojat e pritshme të ndryshimeve klimatike dhe ngjarjet ekstreme⁹, përkeqësimin e kushteve të mjedisit jetësor, urbanizimin intensiv etj. Gjithashtu, gjatë viteve të fundit, ndeshemi me rreziqe dhe kërcënime të reja, si kriza e emigrantëve dhe refugjatëve që është konstante që nga viti 2015, ndotja e madhe e ajrit në qytetet më të mëdha të vendit (kështu, për shembull, Agjencia Evropiane për Mjedisin vlerëson se ekspozimi ndaj grimcave lidhet me 3,400 vdekje të parakohshme dhe një humbje kumulative prej 33,900

⁵ Popovski, Vasko. Një studim mbi politikën publike për përfshirjen e kufizimit në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. UNPRPD MPFT, UNDP. 2023. fq. 1. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/wa9neeww>

⁶ https://issuu.com/zambak69/docs/arm_vo_sprav.so_pozari_vo_2007

⁷ Enti Shtetëror për Statistikë: Njoftim: Dëme nga zjarret malore (Qershor - Shtator 2021). 23.12.2021. Në dispozicion në: http://www.stat.gov.mk/pdf/2021/5.1.21.15_mk.pdf

⁸ International Disaster Database EM-DAT https://www.emdat.be/emdat_db/

⁹ Gjurgjevik, Vladimir. *Climate projection report changes and for changes in the extreme climate events in the Republic of North Macedonia*. UNDP. 2020. faqe. 4. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/yc3r4yaa>

vitesh jetë në Maqedoninë e Veriut në vitin 2019, dhe në bazë të Entin Shtetëror për Statistikë, 5.8% e të gjitha vdekjeve në vitin 2020 janë për shkak të sëmundjeve respiratore¹⁰) ose krizës pandemike me COVID-19, e cila preku shoqërinë, komunitetet dhe qytetarët në një mënyrë të paprecedentë, si në nivel global ashtu edhe në nivel nacional (348,276 raste të sëmurë dhe 9,672 viktima njerëzore¹¹, si dhe humbjet kumulative të vlerësuara për vitin 2020 dhe 2021 prej 3.7 miliardë dollarësh¹²). Nga ana tjetër, shoqëria përballlet me një numër në rritje të sulmeve dhe kërcënimeve kibernetike, si p.sh. Sulmi DDoS në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve gjatë zgjedhjeve të korrikut të vitit 2020¹³, kërcënimet e dërguara me e-mail për bomba të vendosura në 876 institucione arsimore dhe 42 institucione të tjera në periudhën tetor 2022 - mars 2023¹⁴, apo përhapja e lajmeve të rreme dhe dezinformimi¹⁵.

1.2. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe menaxhimi me rreziqet nga katastrofat

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, *menaxhimi i rrezikut nga katastrofat*¹⁶ (ang. *Disaster Risk Management*) zbatohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, përmes sistemeve për menaxhim me kriza, mbrojtje dhe shpëtim, si dhe përmes fushave dhe kompetencave të tjera. Në kontekst të këtij dokumenti, dhe siç është paraqitur më lart, edhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) si bartës i njërit prej tre pushteteve në vend, atë legjislativ, ka kompetenca dhe përgjegjësi të caktuara që janë realizuar në periudhën e kaluar. Roli dhe nevoja për përfshirjen e Kuvendit, veçanërisht erdhi në shprehje gjatë trajtimit dhe rimëkëmbjes nga kriza pandemike me COVID-19. Rrjedhimisht, përmes analizës dhe vlerësimit të reagimit ndaj krizës dhe vendosjes së sistemit për menaxhim me kriza, u miratuan rekomandime të caktuara për të ardhmen. Kështu për shembull, në analizën “*Menaxhimi i krizës si përgjigje ndaj pandemisë me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut*”¹⁷ rekomandohet mbikëqyrja e zbatimit të Programit të Qeverisë si dokument politik i miratuar nga Kuvendi, mbikëqyrje ndaj zbatimit të Strategjisë për Siguri Nacionale, në radhë të parë nga Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri, si dhe nga komisionet e tjera në kuadër të kompetencave të tyre (p.sh. Komisioni për Shëndetësi, Komisioni për Çështjet Ekonomike, etj.), përmirësimi i procedurës së miratimit të ligjeve, përmirësimi i zbatimit të mekanizmave ekzistues mbikëqyrës që Kuvendi i ka në dispozicion, p.sh. pyetjet e deputetëve, puna e komisioneve, seancat mbikëqyrëse dhe vizitat në terren, formimi i komisioneve të posaçme, p.sh. për pandeminë me COVID-19, etj.

* Nëse dëshironi të mësoni më shumë për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat dhe rolin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më shumë informacione janë dhënë në **Shtojcën nr. 3**.

Nga ana tjetër, si rezultat i zbatimit të ushtrimit simulues të kryer për sistemin për menaxhim me kriza në

¹⁰ <https://www.osce.org/blog/530551>

¹¹ <https://covid19.who.int/region/euro/country/mk>

¹² *Social and Economic Evaluation of the COVID-19 impact in North Macedonia*. UNDP. June 2020. p. 8.

¹³ <https://tinyurl.com/2scfm639>

¹⁴ <https://tinyurl.com/5n6m6vu3>

¹⁵ <https://tinyurl.com/2xpctac5>

¹⁶ Shih shtojcën nr. 1 – Terminologjia.

¹⁷ Magdalena Lembovska, Zoran Neçev, Jim Ruff. “Menaxhimi i krizës si përgjigje ndaj pandemisë me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut”. Instituti Nacional Demokratik 2021. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/5ajyahbx>

maj të vitit 2021 “Përgatitja për krizën e ardhshme: Zhvillimi i një sistemi më efikas për menaxhimin e krizave në Maqedoni” e realizuar përmes Programit për Mbështetje Parlamentare¹⁸ u përcaktuan një seri rekomandimesh, nga të cilat më të rëndësishmet janë:

- pjesëmarrja e anëtarëve të caktuar të Kuvendit në grupin e punës për reforma të sistemit për menaxhim me kriza ose realizimin e takimeve për ecurinë e tij para komisioneve kryesore parlamentare;
- zbatimi ushtrimeve të këtij lloji me qëllim lehtësimin e ndërveprimit efikas mes Kuvendit dhe ministrive,
- rregullimi ligjor dhe financimi i procesit për kodifikim të mësimave të nxjerra, me qëllim që të sigurohet se memoria institucionale është e zhvilluar dhe ruhet nga ana e subjekteve të sistemit për menaxhim me kriza,
- miratimi ose kërkesa për miratimin e studimeve mbi pasojat e pandemisë me COVID-19 në të gjitha aspektet e shoqërisë, si dhe mbi ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike, dhe
- realizimi i një ushtrimi vjetor nacional/strategjik për të testuar procesin e vendimmarrjes në sistemin për menaxhim me kriza së bashku me ministritë dhe Kuvendin.

Duke pasur parasysh të gjitha këto dhe me qëllim që të ulen pasojat ekzistuese, të zbuten pasojat e rreziqeve dhe situatave të reja tjera të rrezikshme, si dhe për t’u përgjigjur dhe rimëkëmbur në kohë në mënyrë efikase dhe efektive, është e nevojshme të zbatohen politika të përshtatshme për menaxhim të rrezikut nga katastrofat. Në këtë drejtim dhe “përskej funksioneve të tyre legjislative, buxhetore dhe mbikëqyrëse, **parlamentet luajnë një rol lidhës ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile dhe qytetarëve dhe janë të detyruar të përfaqësojnë dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë sektorëve të shoqërisë. Kjo është kritike kur bëhet fjalë për zvogëlimin e rrezikut; COVID-19 ka treguar se në këtë epokë të rrezikut sistematik, ne nuk jemi të sigurt nëse të gjithë nuk jemi të sigurt.**”¹⁹

2. PARLAMENTET DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE NGA KATASTROFAT NË NIVEL GLOBAL

2.1. Informacione të përgjithshme

Parlamentet luajnë një rol kyç për të siguruar që qeveritë ndërmarrin hapat e duhura për të parandaluar dhe trajtuar krizat dhe katastrofat, dhe se komunitetet janë të përgatitura në mënyrë adekuate për t’u marrë me ndikimin e tyre kur ato të ndodhin. Në këtë drejtim, Unioni Ndërparlamentar në seancën e tij të 141-të të mbajtur në Beograd, Republika e Serbisë (13-17 tetor të vitit 2019) miratoi **Rezolutën për zgjidhjen e ndryshimeve klimatike**²⁰ e cila u bën thirrje “**të gjithë parlamentarëve të përfshijnë uljen e rreziqeve nga katastrofat në strategjitë e tyre të zbatimit dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të Marrëveshjes së Parisit**”²¹, si dhe të bashkëpunojnë me qeveritë e tyre në partneritet me të gjitha palët e interesuara për

¹⁸ <https://tinyurl.com/bdhdx2fr>

¹⁹ <https://tinyurl.com/y2wvbmah>

²⁰ <https://www.ipu.org/event/141st-assembly-and-related-meetings#event-sub-page-20419/>

²¹ <https://tinyurl.com/y2wvbmah>

zbatimin e Marrëveshjes së Parisit për Klimën, zbatimin e shpejtë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke kontribuar në një rezistencë dhe përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve klimatike, dhe veçanërisht përmes dialogut të hapur me brezin e ri. Gjithashtu u bën thirrje të gjitha parlamenteve që t'u bëjnë thirrje qeverive të tyre, në përputhje me Kornizën nga Sendai, të mbështesin mekanizmat gjithëpërfshirëse nacionale për qëndrueshmëri, të forcojnë zvogëlimin dhe parandalimin e rrezikut nga katastrofat, të përmirësojnë gatishmërinë për përgjigje efektive dhe të investojnë në masat zbutëse të rrezikut dhe qëndrueshmërisë sociale.

Megjithatë, në nivel global, tema e pjesëmarrjes së parlamenteve në uljen e rreziqeve nga katastrofat nuk është ende në krye të agjendës, por në kuadër të një qasjeje gjithëpërfshirëse për pjesëmarrjen e të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjitha institucioneve në uljen e rreziqeve, mund të identifikohen mekanizma dhe zgjidhje të duhura.

Parlamentet, në nivel global, janë një nga institucionet kyçe në realizimin praktik të mekanizmave dhe kornizave globale për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistues dhe është e nevojshme të sigurohen detyrimet që dalin nga mekanizmat globalë për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistues (Korniza nga Sendai, Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit për Klimën, etj.) të jenë ligjor, të financuar dhe të implementuar në nivel nacional.

* Nëse dëshironi të mësoni më shumë rreth mekanizmave globalë për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent dhe rolin e parlamenteve në sigurimin dhe zbatimin e tyre, më shumë informacione janë dhënë në **Shtojcën 2**.

Një rast i praktikës së mirë

Protokolli parlamentar për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike: i harmonizuar me Kornizën nga Sendai për uljen e rrezikut nga katastrofat 2015-2030 tenton të drejtojë punën parlamentare për të adresuar nevojat nacionale për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike. Ai gjithashtu synon të mbështesë kontributet legjislative për zbatimin e Kornizës nga Sendai dhe të ofrojë vegla për parlamentet që t'i përdorin për të ndihmuar në forcimin e rezistencës dhe kapaciteteve përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike. Përmbajtja e këtij dokumenti është përafruar me katër prioritetet e Kornizës nga Sendai dhe paraqitet si një protokoll parlamentar që përmban një sërë veprimesh që parlamentarët mund të ndërmarrin për të integruar uljen e rrezikut nga katastrofat në masat legjislative, të kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve për menaxhimin dhe uljen e rrezikut nga katastrofat në vendet e tyre dhe të promovojnë ndërtimin e kapaciteteve në përgjigje dhe përshtatje ndaj katastrofave dhe ndikimeve të ngjarjeve ekstreme që lidhen me ndryshimet klimatike. Shtetet nga rajoni i Amerikës së Veriut dhe Jugut kanë mundësinë ta përdorin këtë protokoll si një vegël praktike.

Burimi: UNDRR <https://tinyurl.com/2p8js4e7>

2.2. Kompetencat në të cilat parlamentet kanë mundësi të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga katastrofat

UNDRR dhe Unioni Ndërparlamentar hodhën themelet për pjesëmarrjen proaktive të parlamenteve në menaxhimin e rrezikut nga katastrofat, duke miratuar dhjetë vegla për parlamentarët²² në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe rezistente në pesë fusha tematike. Sipas tyre, “parlamentarët mund të përkushtohen për uljen e rreziqeve nga katastrofat në rolet e tyre si ligjvënës, ndarës të buxhetit, rishikues dhe miratues, financues, mbikëqyrës ndaj veprimtarive të qeverisë dhe përfaqësues të qytetarëve nga njësitë e tyre zgjedhore.”²³ Si kompetenca kryesore në të cilat parlamentet kanë mundësitë për të kontribuar në uljen e rrezikut nga katastrofat janë si vijon:²⁴

- të miratojnë ligje,
- të zbatojnë mbikëqyrje,
- të marrin pjesë në miratimin e buxhetit dhe mjeteve financiare,
- të prezantojnë, dhe
- të përfaqësojnë.

3. ROLI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË MENAXHIMIN E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT DHE AKTIVITETET E DEPUTETËVE

3.1. Hyrje

Në përputhje me qëllimin e këtij manuali, në këtë kapitull është paraqitur roli i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i shprehur përmes rolit të deputetëve, në tre segmentet e krizës apo katastrofës, gjegjësisht para, gjatë dhe pas. Gjithashtu, këto aktivitete korrespondojnë edhe me katër fazat e menaxhimit të rrezikut nga katastrofat d.m.th., prevenimi, gatishmëria, përballimi dhe rimëkëmbja, siç tregohet në tabelën e mëposhtme. Veprimtaritë specifike janë përcaktuar sipas nevojave të përgjithshme për realizimin e kompetencave të përgjithshme dhe rolit të deputetëve, si dhe sipas pesë kompetencave dhe dhjetë veglave të mësipërme të UNDRR dhe IPU.

²² IPU, UNDRR. *Disaster Risk Reduction to achieve the Sustainable Development Goals A toolkit for parliamentarians*. IPU, UNDRR. 2021. E disponueshme në <https://tinyurl.com/4dh6avuy>

²³ Ibid. faqe.11.

²⁴ Ibid. faqe. 11 – 15.

Tabela 1 – Aktivitetet e deputetëve para, gjatë dhe pas krizës/katastrofës dhe katër fazat e menaxhimit të rrezikut nga katastrofat

Prevenim/Gatishmëri	Përgjigje	Rimëkëmbje
Para krizës/katastrofës	Gjatë kohës së krizës/katastrofës	Pas krizës/katastrofës
Kompetencat e përgjithshme dhe roli i deputetëve		
Të miratojnë ligje		
Të mbikëqyrin		
Të marrin pjesë në miratimin e buxhetit dhe mjeteve financiare		
Të prezantojnë		
Të përfaqësojnë		

3.2. Kompetencat e përgjithshme dhe roli i deputetëve

Në këtë pjesë i është dhënë një rishikim kompetencave të përgjithshme të Kuvendit dhe rolit të deputetëve në uljen e rreziqeve nga katastrofat, në drejtim të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të përgjithshme, me qëllim që të sigurohet vazhdimësi në punën e tyre.

Para krizës/katastrofës

- Mund të kërkonti të njiheni me profilin e rreziqeve të Qytetit të Shkupit dhe Komunës Qendër dhe Planin për Mbrojtje dhe Shpëtim të objektit të Kuvendit;
- Nëse mbahet, duhet të merrni pjesë në një trajnim orientues për mbrojtje dhe shpëtim nga ndërtesa e Kuvendit të organizuar nga shërbimet profesionale, në bashkëpunim me DMSH-në dhe Njësinë Rajonale në Komunën Qendër. Nëse një aktivitet i tillë nuk është parashikuar, ju mund ta inicioni atë;
- Çdo deputet ka të drejtë të marrë një komplet për gjendje emergjente²⁵ që do të përmbajë mjetet e nevojshme të mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes në orët e para pas ngjarjes;
- Nëse jeni të interesuar, mund të kërkonti të merrni pjesë në trajnime për përdorimin e aparatit zjarrfikës ose në ofrimin e ndihmës së parë, aktivitete që do të realizohen në bashkëpunim me NJTZF Shkup, DMSH dhe Kryqin e Kuq;
- Nëse mbahet të paktën një herë në vit, merrni pjesë në një stërvitje të organizuar për evakuim të shpejtë të ndërtesës, në përputhje me Planin për Mbrojtje dhe Shpëtim të Kuvendit. Nëse një aktivitet i tillë nuk është parashikuar, mund ta inicioni në mënyrë të pavarur, me iniciativë të disa deputetëve, nëpërmjet grupeve parlamentare ose trupit punues amë;

²⁵ Një shembull të kompletit për gjendje emergjente mund të gjeni në lidhjen në vijim: <https://tinyurl.com/4b7tpbud>

- Nëse është miratuar *Plani për veprim të zgjatur të Kuvendit*²⁶ në rast të katastrofës me përmasa më të mëdha, nevojitet që të njiheni me të. Nëse nuk është miratuar, mund të filloni procedurën për përgatitjen dhe miratimin e tij në mënyrë të pavarur, me iniciativë të disa deputetëve, përmes grupeve parlamentare ose trupit punues amë;
- Një anëtarë nga Komisioni për siguri nga radhët e anëtarëve të Komisionit nga partia më e madhe opozitare merr pjesë në punën e *Këshillit Drejtues*;
- Mund të inicioni një procedurë për punën e Kuvendit në mënyrë hibride ose onlajn;
- Në rast krize ose katastrofe, nëse keni nevojë, mund të kërkonti ndihmë psikosociale që mund të ofrohet nga punëtorët e autorizuar psikologjikë ose nga ekipet e ekspertëve të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Një rast i praktikës së mirë

Gjatë pandemisë me COVID-19, për të siguruar punën e Parlamentit onlajn, Kili ka bërë një plotësim në Kushtetutë.

Burimi: <https://tinyurl.com/r2swynph>

3.3. Pesë kompetencat për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe roli i deputetëve

1. Të miratojnë ligje – Kompetenca themelore e parlamenteve është miratimi i ligjeve, d.m.th. të miratojnë legjislacionin, me rol dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë të të gjitha subjekteve, të rishikojnë dhe të ndryshojnë legjislacionin sektorial ekzistues, me qëllim që të integrohet ulja e rrezikut nga katastrofat në sektorët e zhvillimit dhe strategjitë, duke reflektuar njëkohësisht detyrimet ndërkombëtare të shtetit, njohuritë dhe rezultatet më të fundit të hulumtimeve shkencore.²⁷ Është veçanërisht e rëndësishme që të integrohen edhe aspektet e përshtatjes së ndryshimeve klimatike, me qëllim që të mundësohet zhvillimi i shtetit dhe shoqërisë, e cila është e informuar për rreziqet klimatike dhe katastrofat. Në këtë kontekst, Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit legjislativ të Republikës, dhe në kuadër të kompetencave të tij, miraton ligje dhe jep interpretim autentik të ligjeve dhe ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare.²⁸ Rrjedhimisht, ju si deputetë keni mundësinë, që në kuadër të procesit të miratimit të ligjeve, të kontribuoni në mënyrë aktive në uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë në tërësi. Përveç kësaj, aktivitetet e mëposhtme janë identifikuar si praktikë më të mira në nivel global dhe nacional para, gjatë dhe pas një krize/katastrofe:

Një rast i praktikës së mirë

Në vitin 2020, Parlamenti Evropian miratoi Ligjin Evropian për Klimën, i cili i detyron institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare të avancojnë kapacitetet e përshtatjes, të forcojnë qëndrueshmërinë dhe të zvogëlojnë cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Gjithashtu Legjislacioni dhe politikat ekzistuese të BE-së janë përditësuar të për përfshirë uljen e rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Burimi: the BE <https://shorturl.at/bfhKX>

²⁶ Me Planin për funksionim të zgjatur të Kuvendit ose një plani të ngjashëm nënkuptohet një plan që do të mbulonte aspektet e funksionimit të zgjatur të Kuvendit në kryerjen e përgjegjësisë të tij dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme në rrethanat e dhëna.

²⁷ IPU, UNDRR. *Disaster Risk Reduction to achieve the Sustainable Development Goals A toolkit for parliamentarians*. IPU, UNDRR. 2021. faqe.16. E disponueshme në <https://tinyurl.com/4dh6avuy>

²⁸ <https://www.sobranie.mk/nadleznosti-na-sobraniето.nspk>

Para një krize/katastrofe

- Mund të kërkon *përmirësimin e njohurive tuaja ekzistuese për menaxhim të rreziqeve nga katastrofat*, p.sh. korniza globale për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent, tendencat globale dhe rajonale për ndërtimin e rezistencës, konteksti nacional. Ky aktivitet mund të realizohet përmes bisedave dhe prezantimeve informative nga përfaqësues të Qendrës për Menaxhim me Kriza, Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe subjekte të tjera, si dhe me projekte për uljen e rreziqeve klimatike dhe rreziqeve nga katastrofat, të financuara nga donatorë bilateralë ose multilateralë;
- Mund të merrni pjesë në një trajnim njëditor *mbi rolin e deputetëve në uljen e rrezikut nga katastrofat* bazuar në këtë manual;
- Nëse jeni anëtar ose zëvendës anëtar i trupit punues amë – Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri, mund të kërkon *mbajtjen e trajnimeve profesionale të fokusuara nga subjektet e mësipërme*;
- Nëse jeni anëtar ose zëvendës anëtar i trupit punues amë – Komisioni për Mbrojtjen dhe Siguri, mund të kërkon *të njiheni me profilet nacionale dhe/ose lokale të rreziqeve*, me qëllim të marrjes së vendimeve dhe akteve, bazuar në informacionin rreth rreziqeve, përmes prezantimeve dhe ndarjes së Vlerësimit të kërcënimit për sigurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet, në mënyrë të përmbledhur ose në tërësi (në koordinim me QMK), si dhe të Vlerësimit të kërcënimit ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut nga aksidentet natyrore dhe aksidente të tjera (në koordinim me ESHS);
- Kuvendi, duhet të krijojë një *koleksion tematik të botimeve* për uljen e rreziqeve nga katastrofat në Bibliotekën Parlamentare, duke përfshirë një koleksion elektronik të dokumenteve dhe informacioneve, në mënyrë që të keni qasje të papenguar në dokumentet globale dhe strategjitë nacionale, ligjet, programet dhe planet për uljen e rreziqeve nga katastrofat;
- Anëtarët dhe zëvendësit nga trupat e punues, por dhe deputetët e tjerë, mund të kërkojnë të hartohet një *rishikim dhe vlerësim i legjislacionit, për uljen e rrezikut nga katastrofat në shtetet e rajonit, shtetet anëtare të BE-së dhe në nivel të vetë BE-së*, si dhe në praktikat të mira nga shtetet e tjera, për zgjidhje ligjore për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat, me qëllim përmirësimin e legjislacionit nacional. Realizimi i këtij aktiviteti mund të ndihmohet nga bashkëpunëtorë të jashtëm, Instituti Parlamentar, institucionet resoriale apo organizata joqeveritare;
- Merrni pjesë aktive në *shkëmbimin e informacioneve, praktikave të mira dhe mësimëve të nxjerra* me përfaqësuesit e parlamenteve nga rajoni dhe nga Unioni Ndërparlamentar, si dhe brenda grupeve parlamentare për bashkëpunim me parlamentet e tjera për procesin e miratimit dhe zbatimit të legjislacioni për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe rolin dhe përvojën e parlamenteve;
- Njihuni me *zhvillimin dhe miratimin e strategjive nacionale për uljen e rrezikut nga katastrofat*, si një nga qëllimet e Kornizës nga Sendai, përmes konsultimit me institucionet përkatëse, Koordinatorit Nacional për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat, i cili është pikë nacionale e kontaktit për Kornizën nga Sendai, përfaqësues nga OKB, UNDRR dhe UNDP;
- Njihuni me *politikat dhe aktet normative për ndryshimet klimatike*, p.sh. korniza ligjore strategjike dhe institucionale, planet dhe kontributet nacionale, raportet dyvjeçare për ndryshimet klimatike, etj. Ky aktivitet mund të realizohet përmes bisedave dhe prezantimeve informative nga përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, subjekteve tjera dhe organizatave joqeveritare, ueb portali <https://klimatskipromeni.mk/>, si dhe nga ana e projekteve për zbutje dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, të financuara nga donatorë bilateralë ose multilateralë;

- Brenda kompetencave tuaja, *promovoni mbledhjen dhe sistematizimin* e informacioneve dhe të dhënave për rrezikun nga katastrofat dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike në nivel nacional dhe sektorial, të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë ndërthurës si moshë, burimi i jetesës, statusi socio-ekonomik dhe përkatësia etnike e popullsisë.²⁹ Në këtë mënyrë, do të kontribuohet në krijimin dhe zbatimin e politikave dhe akteve normative, që do të bazohen në fakte dhe do të përfshijnë aspektet gjinore dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara, por gjithashtu do të kontribuojë në krijimin e zgjidhjeve të disponueshme dhe të drejta për mjedisin jetësor. Katastrofat natyrore, ndryshimet në mjedisin jetësor, zhvendosja dhe dhuna e shkaktuar nga ndryshimet klimatike kanë një ndikim të madh tek gratë dhe vajzat dhe komunitetet më pak të përfaqësuara, duke përfshirë pakicat etnike dhe fetare dhe njerëzit me aftësi të kufizuara;³⁰
- *Njihuni me mënyrën e krijimit të mekanizmave për financim*, që mund të forcohen nga legjislacioni: fondet për katastrofat, huatë dhe sigurimet, duke përcaktuar se si ato do të komunikohen dhe do të jenë në dispozicion për njerëzit me cenueshmëri më të madhe³¹ përmes konsultimeve me institucionet resoriale, përfaqësuesit e OKB-së, UNDRR dhe UNDP, institucionet e tjera financiare ndërkombëtare ose organizatat joqeveritare;
- *Forconi koordinimin ndërsektorial* përmes takimeve konsultative dhe informimeve me institucionet kompetente, subjektet për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare;
- *Si anëtarë dhe zëvendës të Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri, ose të organeve të tjera punuese me rëndësi për uljen e rreziqeve nga katastrofat* për kryerjen e punëve dhe detyrave nga fushëveprimi i tyre, mund të kërkonin të dhëna dhe informacione nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat e tjera, si dhe të ftoni në seancat e trupave punuese tuaja amë, bashkëpunëtorë shkencorë, profesionalë dhe publikë dhe përfaqësues të komunave, qytetit të Shkupit, ndërmarrjeve publike, sindikatave dhe organizatave tjera, institucioneve dhe shoqatave, me qëllim të paraqitjes së mendimeve për çështjet që shqyrtohen në seancën e trupit të punës;³²
- *Si anëtarë dhe zëvendës të Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri, si dhe të trupave të tjerë punues, me rëndësi për uljen e rreziqeve nga katastrofat*, për studimin e çështjeve individuale brenda fushëveprimit të tyre ose për përgatitjen e propozimeve të akteve, mund të formoni grupe të punës. Anëtarët e grupeve të punës do të përcaktohen nga radhët e anëtarëve të trupit punues, deputetët, bashkëpunëtorët shkencorë, profesionalë dhe publikë, si dhe nga përfaqësuesit e organeve të administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat e tjera. Ata do të veprojnë në kuadër të trupit punues dhe nuk mund të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe t'i paraqesin raport trupit punues;³³
- *Sigurohuni që aspektet e uljes së rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, të përfshihen në kornizën e prezantimit dhe arsyetimit të propozim-ligjit* kur është e mundur. Gjithashtu sigurohuni që zgjidhja e re ligjore ose ndryshimi në atë ekzistues të jetë në përputhje me Kornizën nga Sendai dhe kornizën globale për zhvillim të qëndrueshëm, si dhe të jetë gjithëpërfshirës, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve në shoqëri, veçanërisht kategorive më të cenuara të popullsisë;

²⁹ ParlAmericas. UNDRR. *Parliamentary Protocol for Disaster Risk Reduction and Climate Change Adaptation*. 2019. E qasëshme në: https://parlAmericas.org/uploads/documents/ENG_Protocolo_DRR_Online_Version.pdf

³⁰ <https://www.ndi.org/what-we-do/environmental-governance-and-resilience>

³¹ ParlAmericas. UNDRR. *Parliamentary Protocol for Disaster Risk Reduction and Climate Change Adaptation*. 2019. E qasëshme në: https://parlAmericas.org/uploads/documents/ENG_Protocolo_DRR_Online_Version.pdf

³² Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (teksti i konsoliduar), neni 122. Në dispozicion në: <https://www.sobranie.mk/content/Delovnik%20na%20RM/DelovniknaSRMPrecistentekstAvgust13.pdf>

³³ Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i rafinuar), neni 127. Në dispozicion në: <https://www.sobranie.mk/content/Delovnik%20na%20RM/DelovniknaSRMPrecistentekstAvgust13.pdf>

- Merrni pjesë aktive në mbajtjen e debateve publike legislative për çështje dhe probleme që lidhen me propozim-ligje në fushën e uljes së rrezikut nga katastrofat apo nevojës për miratimin e një ligji të ri në këtë fushë, si dhe për të ndihmuar në iniciimin e aktiviteteve shtesë të Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri, komisioneve të tjera ose Kuvendit, me ç'rast plotësohet propozim-ligji, duke shfrytëzuar ekspertizën dhe duke shfaqur interesin publik. Dëshmitarët të cilët paraqesin fakte dhe mendime për një ligj të caktuar në këtë rast, mund të jenë deputetë, përfaqësues të qeverisë, përfaqësues nga subjektet e sistemit për menaxhim me kriza dhe mbrojtje dhe shpëtim, akademia, organizatat shkencore dhe kërkimore, shoqatat e qytetarëve, përfaqësues të grupeve të interesuara dhe qytetarë. Shoqatat e qytetarëve mund të japin dëshmi në propozim-ligjet ndërmjet leximit të parë dhe të dytë, por mund të vazhdojnë të këshillojnë deputetët gjatë marrjes së vendimeve kur një propozim-ligj hyn në fazën e leximit të dytë;³⁴
- Mund të filloni dhe të merrni pjesë aktive në procedurën për miratimin e një rezolute ose rekomandimi, në lidhje me uljen e rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj rreziqeve klimatike;
- Mund të inicioni dhe të merrni pjesë aktive në diskutimin për informacione dhe materiale të tjera që janë dorëzuar nga Qeveria dhe propozues të tjerë të autorizuar (për shembull, nga trupat rregullatorë, nga Enti Shtetëror për Revizion, për shembull Raporti përfundimtar mbi revizionin e performancës “Sistemi për menaxhimin e krizave dhe mbrojtjen nga zjarri” nga dhjetori i vitit 2022³⁵ ose Raporti përfundimtar për revizionin e performancës “Masat ekonomike të Qeverisë së RMV-së për përballimin e krizës së shkaktuar nga virusi Covid-19” nga prilli i vitit 2022,³⁶ etj.), si dhe informacione të dorëzuara nga Qeveria deri te deputeti me kërkesën e tij, nëse deputeti e propozon atë dhe në fund nxirret përfundimi;
- Merrni pjesë aktive në procedurën e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare³⁷ dhe në kuadër të procedurës, deputetët mund të informohen dhe shprehen për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe të kërkojnë shpjegime dhe informacione shtesë nga Qeveria;
- Anëtarët dhe zëvendësit e Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri mund të kërkojnë që në punën e grupit të punës për reformat e sistemit të menaxhimit të krizave të përfshihen përfaqësues nga ky trup pune, si dhe rregullisht të informohet Komisioni dhe Kuvendi për progresin dhe rezultatin përfundimtar.

Gjatë kohës së krizës/katastrofës

- Mund të filloni një procedurë për krijimin e trupave ad-hoc të punës për të punuar gjatë një krize ose katastrofe dhe të merrni pjesë në punën e tyre, nëse nevojitet formimi i tyre për aspekte specifike të përballjes me krizën ose katastrofën;
- Mund të propozoni ose të merrni pjesë aktive në procedurën e miratimit të një ligji me procedurë të shpejtë, kur kjo është e nevojshme për të parandaluar dhe eliminuar çrregullime të mëdha në ekonomi ose kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë

Një rast i praktikës së mirë

Parlamenti i Zelandës së Re krijoi një Komitet për Reagim të Shpejtë ndaj Pandemisë në ditët e para, në mars të vitit 2020.

Burimi: <https://tinyurl.com/r2swynph>

³⁴ NDI. Procesi i dëgjimeve publike. Manual për deputetët dhe shërbimin parlamentar. 2011. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/4phy6nu3>

³⁵ Enti Shtetëror i Revizionit. Raporti përfundimtar i revizionit të performancës “Menaxhimi i krizave dhe sistemi i mbrojtjes nga zjarri “ 02 2022 00 08. 2022. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/ymn8wurn>

³⁶ Enti Shtetëror i Revizionit. Raporti përfundimtar i revizionit të performancës “Masat ekonomike të Qeverisë së RMV-së për përballimin e krizës së shkaktuar nga virusi COVID-19“ 02 2021 00 60. 2022. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/auyyzn49>

³⁷ <https://www.sobranie.mk/nadleznosti-na-sobranieto.nspk>

dhe mbrojtjes së Republikës ose në raste të fatkeqësive të mëdha natyrore, epidemive apo nevojave të tjera të jashtëzakonshme dhe urgjente;

- Merrni pjesë aktive në procedurën e zgjatjes së gjendjes së shpallur të krizës në territorin e Republikës ose një pjesë të saj. Më pas, mund të kërkon informacion plotësuese nga QMK për nevojën, burimet e angazhuara, planet për periudhën e ardhshme dhe koston e zgjatjes së saj, si dhe për çështje të tjera që lidhen me situatën e krizës, dhe me rëndësi për zgjatjen e saj;
- Së bashku me 29 deputetë të tjerë mund të propozoni ekzistim të gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Republikës ose në një pjesë të saj.

Pas krizës/katastrofës

- Mund të propozoni ose të merrni pjesë aktive në procedurën për miratimin e një ligji *lex specialis* për rimëkëmbje, me procedurë të shpejtë, kur kjo është e nevojshme për rregullimin dhe zbatimin e politikave dhe masave për rimëkëmbjen pas një krize ose katastrofe, si dhe për ndihmë solidarë për popullatën e prekur, e veçanërisht grupet e cenuara të qytetarëve;
- Duke marrë pjesë në komisionin amë, mund të kontribuoni në kodifikimin e mësimave të nxjerra dhe praktikave të mira nga përballja me krizën ose katastrofën.

Një rast i praktikës së mirë

Pas përmbytjeve të majit, të vitit 2014, në Serbinë fqinje u miratua Ligji për rehabilitim pas përmbytjeve në Republikën e Serbisë.

Burimi: <https://tinyurl.com/53e3p7uk>

2. Të ushtrojnë mbikëqyrje – Mbikëqyrja parlamentare është roli kyç që kanë parlamentet në segmentin e uljes së rrezikut nga katastrofat. Aktivitetet mbikëqyrëse mund të kryhen periodikisht për të monitoruar zbatimin e legjisllacionit apo nismave të caktuara programore të ndërtimit të qëndrueshmërisë, pas përfundimit të tyre ose pasi është shpallur një krizë apo gjendje e jashtëzakonshme, si pasojë e një ngjarjeje katastrofike. Mekanizmi i mbikëqyrjes është veçanërisht i dobishëm për analizimin e situatës ose ngjarjes, identifikimin e dobësive dhe sfidave, formulimin e rekomandimeve, identifikimin e praktikave të mira dhe mësimet e nxjerra, si dhe për ndryshimin dhe përmirësimin e mëvonshëm të kornizës ligjore, për rezultate të përmirësuara në menaxhimin e rrezikut nga krizat dhe zbatimin e kompetencave dhe mandateve. Pakoja e veglave të UNDRR dhe IPU parashikon që gjatë kryerjes së funksionit mbikëqyrës, deputetët duhet të kenë një kuptim të qartë të përgjegjësive sipas kornizës normative për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe zbatimin e ligjeve përkatëse, transparenca dhe llogaridhënia janë të përfshira në politikat dhe ligjet për uljen e rreziqeve nga katastrofat, qasja në informacione mundësohet me kohë, janë të përfshira të gjitha partitë parlamentare, nëse është e nevojshme thirren edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, përfshihen perspektivat dhe nevojat e kategorive të cenuara të popullsisë, ekziston një gatishmëri për të zbuluar korrupsionin e mundshëm dhe thirrjen e Qeverisë për

Një rast i praktikës së mirë

Pas Tërmetit të Madh, të vitit 2011, Qeveria e Japonisë përgatit çdo vit një Libër të Bardhë për menaxhim me katastrofa dhe ia paraqet parlamentit. Libri i Bardhë përfshin një pasqyrë të katastrofave që kanë ndodhur, statistika të ndryshme dhe masat për menaxhim me katastrofa, të ndërmarra nga Qeveria, përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar sistemin dhe legjisllacionin që pasqyron mësimet e nxjerra, transparençën dhe llogaridhënien.

Burimi: <https://shorturl.at/vxzBZ>

përgjegjësi, nëse kjo është rezultat i gjetjeve të mbikëqyrjes. Në asnjë rast mbikëqyrja nuk përbën procedurë hetimore.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ushtron kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e funksioneve të tjera publike që janë përgjegjës para Kuvendit.³⁸ Me ç'rast, mekanizmat në dispozicion janë si më poshtë: seancat mbikëqyrëse, seancat hetimore përmes komisioneve hetimore ad-hoc, vizitat në terren, pyetjet e deputetëve dhe interpelanca. Nga praktika e mëparshme, mekanizmi mbikëqyrës nuk është aktivizuar për çështjet të uljes së rrezikut nga katastrofat, përkundër faktit se ka pasur iniciativë për aktivizimin e tij, p.sh. pas përmbajtjes katastrofike në Shkup në gusht të vitit 2016 ose gjatë menaxhimit të deklaruar të krizës me pandeminë me COVID -19 , por për shkak të ndikimeve të caktuara politike nuk janë realizuar.

Një rast i praktikës së mirë

Në Parlamentin e Gjeorgjisë, në shtator të vitit 2020, partia më e madhe opozitare nisi procedurën për interpelancë të Qeverisë, në lidhje me pasojat ekonomike të COVID-19.

Burimi: <https://tinyurl.com/r2swynph>

Rrjedhimisht, ju si deputetë, keni mundësinë në kuadër të ushtrimit të mbikëqyrjes, të kontribuoni në mënyrë aktive në uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe në ndërtimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë në tërësi. Në të njëjtën kohë, aktivitetet e mëposhtme janë identifikuar si praktikat më të mira në nivel global dhe nacional para, gjatë dhe pas një krize/katastrofe:

- *Ndërtoni partneritete solide dhe bashkëpunim me institucionet e pavarura për mbikëqyrje për të siguruar shkëmbim rutinor të informacioneve gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi Qeverinë, në mënyrë që të sigurohet qasje në të dhënat ekonomike dhe fiskale që të informohen komisionet që ushtrojnë mbikëqyrje;*³⁹
- *Mund të kërkonti mbajtjen e seancës mbikëqyrëse ose të merrni pjesë në të, me ç'rast shqyrtohet puna e Qeverisë në uljen e rreziqeve nga katastrofat, gjegjësisht në zbatimin e ligjeve të miratuara nga Qeveria, si dhe efekti i zyrtarëve dhe punonjësve të Qeverisë në ekzekutimin e mandateve ligjore. Me ç'rast, ju mund të hetoni nëse korniza ekzistuese respektohet dhe nëse ajo është në shërbim të interesit publik;*
- *Mund të kërkonti formimin e komisioneve ad-hoc të anketimit ose të merrni pjesë në punën e tyre, që do të merreshin me çështjen e uljes së rrezikut nga katastrofat;*
- *Nëse jeni anëtar ose zëvendës anëtar i Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri ose i ndonjë komisioni tjetër që lidhet me menaxhimin e rrezikut nga katastrofat, mund të inicioni dhe/ose të merrni pjesë në një vizitë/debat në terren. Me ç'rast, diskutohet për zbatim konkret të politikave/aktiviteteve/përballjes me një krizë apo katastrofë, dhe ka mundësi për të mbledhur dhe shkëmbyer informacione dhe të dëgjohen deklaratat e dëshmitarëve të ndryshëm. Është veçanërisht me rëndësi nëse diskutimi zhvillohet në vendin përkatës (për shembull, në një zonë të prekur nga një përmbajtje ose rrëshqitje dheu) dhe një komunitet të ekspozuar në rrezik, i prekur nga një ngjarje katastrofike ose gjatë një vizite nga subjektet për menaxhim me kriza dhe mbrojtje dhe shpëtim;*
- *Pyetjet e deputetëve janë një tjetër lloj mekanizmi mbikëqyrës dhe përmes tyre deputetët pyesin Kryetarin e Qeverisë, anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e tjerë të funksioneve publike që përgjigjen para Kuvendit për*

³⁸ <https://www.sobranie.mk/nadleznosti-na-sobranieto.nsp>

³⁹ NDI.USAID. IRI. Roli i Parlamentit në politikën fiskale gjatë gjendjes së jashtëzakonshme: mësimet e nxjerra për planifikimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2ck4spu5>

çështje të punës së tyre ose për çështje të kompetencave të tyre në uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Si shembull, janë pyetjet që u ngritën në lidhje me gjendjen e shpallur të krizës energjetike dhe ngrohjes;

- *Paraqisni një interpelancë* në lidhje me punën e një bartësi të caktuar të një posti publik, Qeverinë dhe secilit prej anëtarëve të saj individualisht, si dhe në lidhje me çështjet nga puna e organeve shtetërore e në lidhje me menaxhimin e rrezikut nga katastrofat.

3. Të marrin pjesë në miratimin e buxhetit dhe mjeteve financiare - Ky funksion udhëzon në miratimin e një buxheti dhe zhvillimin e strategjive dhe instrumenteve financiare, të cilat janë të informuara për uljen e rreziqeve nga katastrofat, me qëllim që të financohen investime afatgjata për uljen e rreziqeve, duke përfshirë edhe fondet për mbikëqyrje mbi mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe zbatimin e rregullativës në të gjitha nivelet e pushtetit, duke përfshirë edhe integrimin e uljes së rrezikut nga fatkeqësitë në vendimet për investimet publike dhe private, për të ofruar investime që janë të informuara për rreziqet. Në kuadër të këtij funksioni janë proceset dhe aktivitetet e deputetëve, që kanë të bëjnë me diskutimin e buxhetit, miratimin e buxhetit dhe monitorimin e zbatimit të tij, si dhe kornizat financiare për investime në uljen e rreziqeve nga katastrofat. Gjatë procedurës për miratimin e buxhetit ose rebalancin e të njëjtit, deputetët kanë funksionin e korrigjimit të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, ku me pjesëmarrjen dhe përkushtimin e tyre aktiv, mund të ndikohet në rritjen e fondeve, që synojnë uljen e rreziqeve nga katastrofat ose *financimit reaktiv*, gjegjësisht financimi për përballje me kriza dhe katastrofa, të bëhet *proaktiv*, domethënë pjesa dominuese e mjeteve financiare të përcaktohen për parandalimin dhe zbutjen e pasojave ekzistuese të rreziqeve dhe kërcënimeve të reja, si dhe për të siguruar investime që do të informohen për rrezikun.

Kuvendi përcakton detyrimet publike, miraton buxhetin republikan dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit dhe vendos për rezervat e Republikës.⁴⁰ Gjatë procedurës së miratimit të buxhetit, është e nevojshme t'i kushtoni vëmendje aspekteve të mëposhtme, me qëllim që të miratohet një buxhet që do të përmbajë programe për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve klimatike ekzistuese dhe të reja dhe rreziqeve nga katastrofat, dhe do të kontribuojë në ndërtimin e gjithanshëm të qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe komuniteteve.

Para krizës/katastrofës⁴¹

- *Kuptoni* procedurat e vendimmarrjes, afatet kohore, institucionet e përfshira dhe rezultatet kryesore të çdo faze të ciklit buxhetor, njihuni me *strukturën dhe përmbajtjen e formularit dhe dokumentit të buxhetit* që në mënyrë më të lehtë dhe më efektive të merrni pjesë në procesin e miratimit të tij;
- *Vendosni një komunikim të hershëm me ministrinë dhe autoritetet e tjera buxhetore për të përfshirë kontributin parlamentar përpara dorëzimit të buxhetit vjetor të shtetit për miratim në Parlament,*⁴²

⁴⁰ <https://www.sobranie.mk/nadleznosti-na-sobraniето.nspx>

⁴¹ Këto aktivitete mund të realizohen përmes bisedave dhe prezantimeve informative, si dhe përgatitjes së analizave në bashkëpunim me shërbimet profesionale, bashkëpunëtorët, Institutin Parlamentar, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe institucionet kompetente, organizatat joqeveritare, odat ekonomike, si dhe me organizatat ndërkombëtare që zbatojnë projekte me profil të ngjashëm.

⁴² NDI.USAID. IRI. *Roli i Parlamentit në politikën fiskale gjatë një gjendje të jashtëzakonshme: mësimet e nxjerra për planifikimin e gjendjes së jashtëzakonshme.* Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2ck4spu5>

- *Identifikoni nëse buxheti i parashikuar është rezultat i profilit të rreziqeve sipas vlerësimit nacional, duke përfshirë skenarët klimatik⁴³, si dhe nëse ato mbështesin planet e veprimit të strategjive zhvillimore dhe planeve të përshtatjes, etj;*
- *Identifikoni nëse fondet e buxhetuara janë për programe reaktive, gjegjësisht për përballje me kriza dhe katastrofa, ose proaktive, gjegjësisht për parandalimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Këtë mund ta bëni duke shqyrtuar zërat dhe qëllimin e fondeve;*
- *Kërkoni ose përgatitni një pasqyrë të fondeve të buxhetuara për ulje të rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike gjatë pesë viteve të fundit, në mënyrë që të analizoni trendin e financimit publik në këto fusha;*
- *Identifikoni shumat buxhetore të dedikuara për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike dhe llogaritni se sa për qind përfaqësojnë ato nga buxheti total i propozuar me qëllim të monitorimit të buxhetimit të këtyre fushave, si dhe për prioritizimin e tyre;*
- *Identifikoni se sa nga fondet e planifikuara buxhetore për uljen e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike janë të dedikuara për nevojat e kategorive të cenuara të qytetarëve. Zakonisht duhet të përfshihen në të gjitha programet, me qëllim që të përmirësojnë qëndrueshmërinë e tyre, mund të ketë edhe programe të specializuara në përputhje me nevojat dhe aftësitë e tyre;*
- *Identifikoni rajonet, sektorët, komunitetet dhe kategoritë e popullsisë së ekspozuar dhe të cenuar, në të cilat duhet investuar në ndërtimin e qëndrueshmërisë. Pika fillestare është vlerësimi i rreziqeve, dokumentet nga fusha e ndryshimeve klimatike, strategjitë sektoriale, planet dhe programet;*
- *Kontrolloni nëse janë të përfshira kriteret për vlerësimin dhe menaxhimin e ndikimit të rrezikut nga katastrofat dhe ndryshimet klimatike në operacionet komerciale dhe investimet publike, për të siguruar që investimet të jenë të qëndrueshme edhe në afat të gjatë edhe në ndikimet më të rënda klimatike;⁴⁴*
- *Identifikoni nëse gjatë përcaktimit të fondeve buxhetore për programet janë përdorur mjete dhe metodologji për vlerësimin e prioritetit të investimit, për shembull, analiza e vlerës së harxhimeve (ang. Cost Benefit Analysis);*
- *Kontrolloni nëse janë paraparë mjete buxhetore për zbatimin e strategjive dhe planeve të zhvillimit ekzistues apo të ri për përshtatje, etj. Vetëm nëse janë përcaktuar mjete financiare, mund të flitet për realizimin e tyre brenda afatit të përcaktuar dhe përmbushjen e rezultateve të pritura;*
- *Identifikoni nëse janë paraparë mjete buxhetore për përmbushjen e detyrimeve të shtetit sipas kornizave globale për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, në lidhje me uljen e rreziqeve nga katastrofat. Në shumë raste, shteti nuk përmbush detyrimet e veta financiare në bazë të anëtarësisë në organizata ndërkombëtare apo detyrimet e bazuara në këto mekanizma globalë dhe kjo praktikë potencialisht mund të ketë një ndikim negativ në financimin e uljes së rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;*

Një rast i praktikës së mirë

Gjatë pandemisë me COVID-19, për të ofruar mbështetje emergjente dhe stimuluese për komunitetet dhe sektorët e goditur rëndë, procedurat buxhetore u modifikuan përkohësisht. Në Australi, Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar, procesi normal i planifikimit të buxhetit të vitit fiskal është lënë përkohësisht mënjanë për të adresuar nevojat e menjëhershme të shpërndarjes së buxhetit emergjent që dolën në pah si rezultat i pandemisë.

Burimi: <https://tinyurl.com/yc23zem5>

⁴³ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. 4 Plani Nacional për Ndryshimet Klimatike. 2023. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/mwy6kbwz>

⁴⁴ ParlAmericas. UNDRR. *Parliamentary Protocol for Disaster Risk Reduction and Climate Change Adaptation*. 2019. Në dispozicion në: https://parlAmericas.org/uploads/documents/ENG_Protocolo_DRR_Online_Version.pdf

- Promovoni mekanizmat për transferim të rrezikut, duke mundësuar subvencionimin e harxhimeve për sigurim nga rreziqet prej katastrofave dhe të ngjashme, dhe sigurimin e mekanizmave për të mbështetur sektorët dhe popullatën e cenuar;
- Inicioni pjesëmarrje më të madhe të sektorit privat dhe investimeve të përbashkëta në uljen e rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- Identifikoni palët kryesore të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe qendrat kërkimore dhe analitike (think tanks) dhe institucionet akademike, të cilat kanë ekspertizë në politikat ekonomike dhe fiskale për të mundësuar që ekspertiza e tyre të sigurojë mbështetje në punën e Parlamentit dhe komisioneve të tij;⁴⁵
- Kontrolloni nëse buxheti ka mjete të paprogramuara, zëra me shuma të palogjikshme etj., të cilat i referohen uljes së rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;
- Paraqisni amendamente në zërat e propozuar të buxhetit, nëse është e nevojshme, me qëllim që të financohet ndërtimi i qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe komuniteteve, nëpërmjet uljes së rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;
- Merrni pjesë në procedurën për miratim të buxhetit;
- Në procedurën e rebalancit të buxhetit, përsëriten të gjitha ose disa nga këto hapa ose vendosen ato të reja, varësisht nga nevojat e identifikuar dhe specifikat e procedurës së rebalancit të buxhetit.

Gjatë kohës së krizës/katastrofës

- Merrni pjesë në procedurën për rebalanc të buxhetit konform nevojave të përballjes me krizën apo katastrofën.
- Merrni pjesë në hartimin, miratimin dhe monitorimin e programeve për gjendje të jashtëzakonshme, për të siguruar që ato të synojnë ata që janë më të prekur dhe minimizojnë harxhimet e panevojshme dhe korrupsionin;⁴⁶
- Mendoni për përfshirjen e kërkesave të detyrueshme dhe rutinore për dorëzimin e raporteve për politikën e lehtësimit fiskal në gjendje të jashtëzakonshme në legjislacion, me të cilat mundësohet aprovimi i shpenzimeve në lidhje me këto politika;⁴⁷
- Inkurajoni transmetimin e informacioneve të kuptueshme dhe të disponueshme mbi dispozitat e buxhetit për gjendjen e jashtëzakonshme, për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien, si në aspektin e përmbajtjes buxhetore, ashtu edhe në procesin e buxhetit.⁴⁸

Pas krizës/katastrofës

- Merrni pjesë në procedurën e rebalancit të buxhetit sipas nevojave të rimëkëmbjes nga kriza apo katastrofa.
- Propozoni krijimin e fondeve për raste emergjente dhe rikonstruim pas katastrofës, me fokus të veçantë në komunitetet më të cenueshme;⁴⁹
- Nëse është e nevojshme, inicioni miratimin e një kornize për ndarjen e fondeve buxhetore për ndihmë solidare për kategoritë më të cenueshme të popullsisë së prekur;

⁴⁵ NDI,USAID. IRI. Roli i Parlamentit në politikën fiskale gjatë një gjendje të jashtëzakonshme: mësimet e nxjerra për planifikimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2ck4spu5>

⁴⁶ Ibid.

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ ParlAmericas. UNDRR. Parliamentary Protocol for Disaster Risk Reduction and Climate Change Adaptation. 2019. Në dispozicion në: https://parlAmericas.org/uploads/documents/ENG_Protocolo_DRR_Online_Version.pdf

- Në rast të rimëkëmbjes pas katastrofës, sigurohuni që parimi *Ndërtoni përsëri më mirë* (ang. *Build Back Better*) është përfshirë më mirë në investimet buxhetore nëpërmjet informimit për të njëjtat;
- Merrni pjesë në vizitat në terren në vendet e rimëkëmbjes, për të mbledhur informacione dhe njohuri mbi aktivitetet e rimëkëmbjes në zonat dhe popullatën e prekur.

4. Të përfaqësojnë – Parlamentarët, si përfaqësues të zgjedhur nga zgjedhësit e tyre në njësitë zgjedhore, kanë mundësinë t'i përfaqësojnë nevojat dhe prioritetet e tyre për uljen e rreziqeve nga katastrofat, duke u siguruar se ato janë të përfshira në politikat dhe masat e duhura. Gjithashtu, parlamentet janë përgjegjës për ratifikimin dhe mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve të shteteve në bazë të marrëveshjeve dhe mekanizmave ndërkombëtare, dhe në këtë drejtim, parlamentarët mund të sigurojnë që zbatimi i politikave dhe masave përkatëse i përfaqësojnë nevojat e qytetarëve dhe u përket të gjitha kategorive të qytetarëve. Rrjedhimisht, përmes rolit të tyre në këto procese, parlamentarët kontribuojnë në realizimin e dy parimeve bazë të uljes së rrezikut nga katastrofat, e ato janë të gjitha nivelet e pushtetit dhe të gjithë në shoqëri, përmes konsultimit dhe koordinimit multi sektorial, duke përfshirë pushtetarët në nivel qendrorë dhe lokal, sektori privat, organizatat joqeveritare, akademia, organizatat kërkimore-shkencore, shoqatat e qytetarëve etj.

Në realizimin e këtij funksioni, një pjesë e aktiviteteve kryhen në Kuvend, e disa jashtë tij, duke siguruar ndërveprim dhe bashkëpunim me subjektet dhe qytetarët e ndryshëm për ndërtimin e qëndrueshmërisë. Me këtë rast, ju si deputet mund të siguronit promovimin e përfshirjes së të gjithëve në shoqëri në uljen e rreziqeve nga katastrofat nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve të mëposhtme, të cilat janë identifikuar si praktikë më të mira në nivel global dhe nacional *para, gjatë dhe pas një krize/katastrofe*:

- *Inicioni ose merrni pjesë në mbajtjen e dëgjimeve publike* për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe realizimin e detyrimeve të shtetit në kontekst të mekanizmave globalë së bashku me subjektet kryesore, organizatat joqeveritare dhe shoqatat e qytetarëve;
- *Inicioni formimin dhe/ose merrni pjesë në punën e Klubit të Deputetëve/grupe joformale* për promovimin e agjendës për ndërtimin e qëndrueshmërisë, gjatë së cilës mund të kryhen edhe aktivitete për ndërgjegjësimin e deputetëve të tjerë, miratimin e strategjive gjithëpërfshirëse, ligjeve, etj;
- *Merrni pjesë në seancën tematike për të shënuar Ditën Ndërkombëtare për Uljen e Rreziqeve nga Katastrofat*, më 13 tetor çdo vit, në të cilën do të diskutohet për progresin në ndërtimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe të komunitetit, dhe për aspektet specifike të uljes së rreziqeve nga katastrofat sipas programit vjetor të UNDRR-së;⁵⁰
- *Merrni pjesë si përfaqësues nga Kuvendi ose si anëtarë dhe zëvendës anëtarë të Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri në punën e Platformës Nacionale për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat;*

Një rast i praktikës së mirë

Platformat Nacionale për uljen e Rreziqeve nga Katastrofat janë forume multi-sektoriale që përfshijnë palët kryesore të interesit në shtet, përmes shkëmbimit të njohurive, informacionit, praktikave të mira dhe mësimave të nxjerra, koordinimit dhe bashkëpunimit, për të kontribuar së bashku në përparimin strategjik në uljen e rreziqeve në shtete. Në disa prej tyre, si në Indi, parlamentet janë të përfshirë në mënyrë aktive dhe kontribuojnë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe komuniteteve.

Burimi: <https://tinyurl.com/mt4tnshm>

⁵⁰ <https://iddrr.undrr.org/>

- Merrni pjesë si përfaqësues nga Kuvendi ose si anëtarë dhe zëvendës anëtarë të Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri në punën e grupeve të ndryshme të punës, debatet e ekspertëve etj;
- Ndërtoni partneritet me organizatat joqeveritare, me qëllim që të angazhohet publiku në krijimin e politikave gjithëpërfshirëse përmes diskutimit dhe komunikimit të përmirësuar dhe përmes miratimit dhe zbatimit të zgjidhjeve që do të kontribuojnë në ndërtimin e qëndrueshmërisë të të gjithëve në shoqëri;
- Një aspekt tjetër i këtij funksioni ka të bëjë me *kontaktet tuaja me qytetarët* në njësitë zgjedhore, me ç'rast një ditë në javë është e caktuar për kontakte me qytetarët dhe votuesit në njësitë zgjedhore. Shfrytëzoni këto kontakte edhe në lidhje me uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet;
- informimit për gjendjet dhe nevojat lokale;
- nivelit të përfshirjes së qytetarëve në uljen e rreziqeve;
- përfshirja e grave dhe pjesëtarëve të kategorive të tjera të cenueshme të popullsisë, me qëllim që të ulët cenueshmëria e tyre dhe të rritet rezistenca ndaj krizave dhe katastrofave, inkurajimi për pjesëmarrjen e tyre në proceset e miratimit të politikave dhe zbatimit të aktiviteteve në nivel lokal dhe nacional;
- edukimi dhe përfshirja, veçanërisht e të rinjve, si palë aktive në ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e kulturës politike për uljen e rreziqeve nga krizat dhe katastrofat;
- ndarja e materialeve informative dhe publikimeve për uljen e rreziqeve në njësitë zgjedhore;
- informimin e qytetarëve për aktivitetet e ndërmarra për uljen e rreziqeve;
- kontribuoni në qetësimin e situatës, duke shpërndarë informacione të verifikuara dhe në kohë, dhe mbështetje psikologjike për popullatën e prekur.

Në rast të kufizimeve, si për shembull gjatë pandemisë me COVID-19, ofroni takime/konsultime virtuale me qytetarët në zonat tuaja zgjedhore ose organizoni ato në përputhje me kufizimet dhe distancën aktuale.

Bëhuni më të pranishëm në mediat sociale dhe përdorni veglat për biseda ose diskutime të transmetuara drejtpërdrejt.

Një rast i praktikës së mirë

Gjatë pandemisë me COVID-19, Maroku siguroi komunikim të koduar me qytetarët e tij në platformën WhatsApp.

Burimi: <https://tinyurl.com/r2swynph>

5. Të përfaqësojnë – Përfaqësimi parlamentar dhe rritja e ndërgjegjësimit për uljen e rrezikut nga katastrofat janë thelbësore për ndërtimin e një kulture të rezistimit të shoqërisë dhe komuniteteve. Përfaqësimi duhet të kontribuojë në një qasje proaktive për uljen e rrezikut nga katastrofat, bashkëpunimin nacional, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe kyçje gjithëpërfshirëse të uljes së rrezikut nga katastrofat në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe planet e zhvillimit, si dhe në iniciativat për të rritur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë.⁵¹

Në këtë kontekst, parlamentet mund të bashkëpunojnë me parlamente të tjera nacionale dhe organizatat ndërkombëtare, për të ndarë praktikën më të mira dhe për të koordinuar përpjekjet për menaxhimin e rrezikut nga katastrofat përtej kufijve. Veç kësaj, ju, si deputetë, mund të rrisni ndërgjegjësimin për rreziqet nga katastrofat dhe rëndësinë e gatishmërisë dhe reagimit në rast katastrofe, përmes fushatave të ndërgjegjësimit

⁵¹ IPU, UNDRR. *Disaster Risk Reduction to achieve the Sustainable Development Goals A toolkit for parliamentarians*. IPU, UNDRR. 2021. faqe.16. Në dispozicion në <https://tinyurl.com/4dh6avuy>

publik, komunikimit me mediat dhe kanaleve të tjera të komunikimit, duke zbatuar aktivitetet e mëposhtme, që janë identifikuar si praktikatat më të mira në nivel global dhe nacional *para, gjatë dhe pas një krize/katastrofe*:

- *Inicioni ose merrni pjesë në formulimin e praktikave të mira dhe mësimet të nxjerra nga krizat e mëparshme*, gjendjet emergjente dhe ngjarjet katastrofike dhe rolin e Kuvendit;
- *Merrni pjesë në transmetimin e emisioneve tematike* përmes kanalit parlamentar, me qëllim të forcimit të ndërgjegjësimit të qytetarëve për uljen e rreziqeve dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- *Merrni pjesë aktive në dialog*⁵² me përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe sektorin privat, për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Në dialog duhet të shqyrtohet se si strategjitë për zbutje dhe përshtatje do të marrin parasysh ekspozimet e ndryshme, dobësitë dhe kapacitetet e grave, të rinjve dhe të moshuarve, personave me nevoja të veçanta dhe të tjerëve. Gjithashtu dialogu duhet të adresohet edhe në strategjitë për promovim të pjesëmarrjes së rëndësishme të këtyre grupeve ose individëve në uljen e rreziqeve;
- *Merrni pjesë aktive në aktivitetet lokale* për ngritje të kapaciteteve për uljen e rreziqeve nga katastrofat, si trajnime, stërvitje, konferenca, stërvitje taktike-demonstruese, shfaqje, debate, forume, etj. me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë e popullatës lokale;
- *Merrni pjesë aktive në informimin dhe ngritjen e ndërgjegjes publike* për ekspozimin dhe cenueshmërinë ndaj rreziqeve të njësive lokale zgjedhore;
- *Kontribuoni në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërkufitar* për uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke ndarë mësimet e nxjerra dhe praktikatat e mira nga vendet e tjera, duke krijuar një rrjet parlamentesh për ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj rreziqeve klimatike dhe nga katastrofat në Ballkanin Perëndimor/Evropën Juglindore, pjesëmarrje aktive në bashkëpunimin me parlamentet e vendeve të tjera dhe në punën e Unionit Ndërparlamentar etj;
- *Merrni pjesë si përfaqësues të Kuvendit në ngjarjet globale*, siç është Platforma Globale për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat që mbahet çdo dy vjet;
- *Inicioni dhe merrni pjesë aktive në miratimin e rezolutave për ndërtimin e qëndrueshmërisë në nivel rajonal, nacional dhe lokal*, etj.;
- *Kontribuoni në luftën kundër lajmeve të rreme dhe dezinformatave*, duke verifikuar burimin dhe besueshmërinë e informacionit dhe duke transmetuar informacione në kohë dhe të verifikuara para, gjatë dhe pas krizës ose katastrofës.

⁵² ParlAmericas. UNDRR. *Parliamentary Protocol for Disaster Risk Reduction and Climate Change Adaptation*. 2019. Në dispozicion në: https://parlAmericas.org/uploads/documents/ENG_Protocolo_DRR_Online_Version.pdf

Shtojca 1 – TERMINOLOGJIA BAZË

Fatkeqësi të tjera janë ngjarje që janë rezultat i disa pakujdesive dhe gabimeve të caktuara në kryerjen e punëve të përditshme ekonomike dhe aktiviteteve të tjera, si dhe pakujdesitë në trajtimin e substancave dhe mjeteve të rrezikshme gjatë prodhimit, ruajtjes dhe transportit të tyre (zjarre, aksidente të mëdha rrugore, hekurudhore dhe të trafiku ajror, aksidentet në miniera, aksidentet industriale, të shkaktuara nga shpërthime dhe shkaqe të tjera tekniko-teknologjike, rënia e reshjeve radioaktive, pluhuri dhe shtresat, derdhjet e naftës dhe derivateve të naftës dhe kimikateve të tjera toksike, shpërthimet e gazeve, lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, si dhe substanca të tjera të djegshme që krijojnë përzierje shpërthyes me ajrin dhe materiale të tjera shpërthyes në një shkallë më të madhe). (Ligji për Mbrojtje dhe Shpëtim – Teksti redaktues i konsoliduar, neni 2, paragrafi 1, pika 2)

Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet e tjera është marrja e masave organizative, teknike dhe masave të tjera, dhe përdorimi i mjeteve teknike dhe mjeteve të tjera për mbrojtjen e menjëhershme personale dhe kolektive të njerëzve, jetës së kafshëve dhe bimëve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga pasojat e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet e tjera. (Ligji për Mbrojtje dhe Shpëtim - Teksti redaktues i konsoliduar, neni 2, paragrafi 1, pika 4)

Ekspozimi është prania e njerëzve, të mirave materiale, burimeve natyrore, sistemeve, objekteve ose elementëve të tjerë në zonat e rrezikut dhe të cilët, me praninë dhe cenueshmërinë e tyre, janë të ndjeshëm ndaj humbjeve, dëmtimeve dhe ndikimeve të tjera negative. (Rregullore për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin e menaxhimit të krizave, të cilave u dorëzohet një ekstrakt nga vlerësimi, 128/23, neni 2, paragrafi 1, pika 4)

Katastrofa është një prishje serioze e funksionimit të komunitetit ose shoqërisë të çfarëdo shkalle për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit, duke çuar në një ose më shumë nga këto: humbje njerëzore, materiale, ekonomike dhe humbje ekologjike dhe ndikime. (UNDRR, <https://www.undrr.org/terminology/disaster>)

Kriza është një dukuri që kërcënon vlerat themelore, interesat dhe qëllimet e përhershme dhe jetike të shtetit, përkatësisht është rrezikuar rendi kushtetues dhe siguria e Republikës. (Ligji për menaxhim me kriza 29/05, neni 3, paragrafi 1, pika 4)

Gjendja e krizës është një situatë e shkaktuar nga rreziqe që mund të kërcënojnë të mirat, shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe kafshëve dhe sigurinë e Republikës, për parandalimin e të cilave dhe/ose trajtimin e të cilave kërkohet përdorimin e një sasive më të madhe të resurseve. (Ligji për menaxhim me kriza 29/05, neni 3, paragrafi 1, pika 5)

Ulja e rrezikut nga katastrofat (ang. Disaster Risk Reduction) ka për qëllim të parandalojë rreziqet e reja dhe të ulë rreziqet ekzistuese nga katastrofat, si dhe të menaxhojë rrezikun e mbetur, duke kontribuar kështu në forcimin e qëndrueshmërisë dhe më pas arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. (UNDRR, <https://tinyurl.com/ubdb2xhc>)

Prevenimi është një grup aktivitetesh të planifikuara, të organizuara dhe të menaxhuara në mënyrë institucionale, që synojnë uljen ose shmangien e plotë të ndikimeve negative të rreziqeve dhe aksidenteve dhe katastrofave të lidhura me to. (Rregullorja për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin e menaxhimit të krizave, të cilave u dorëzohet një ekstrakt nga vlerësimi, 128/23, neni 2, paragrafi 1, pika 7)

Fatkeqësitë natyrore janë tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet e tokës, ortekët e borës dhe rrëshqitjet, stuhitë, stuhitë me breshër, thatësitat që kërcënojnë mjedisin, jetën dhe shëndetin e njerëzve, të mirat materiale, jetën e kafshëve dhe bimëve dhe trashëgiminë kulturore me forca të pakontrollueshme natyrore (Ligji për mbrojtje dhe shpëtim - Teksti redaktues i konsoliduar, neni 2, paragrafi 1, pika 1)

Rreziku është një dukuri natyrore, aktivitet njerëzor, avari tekniko-teknologjike ose lloj tjetër dukurie që mund të shkaktojë: humbje jete, lëndime ose ndikime të tjera në shëndet, dëmtim të pronës, humbje të mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, çrregullime sociale dhe ekonomike, si dhe dëmtim ndaj mjedisit jetësorë. (Rregullore për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin i menaxhimit të krizave të cilëve u dorëzohet ekstrakt nga vlerësimi, 128/23, neni 2, paragrafi 1, pika 2)

Rezistimi është aftësia e sistemit për menaxhim me kriza, komunitetit lokal ose shoqërisë, të cilët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve, të rezistojnë, të absorbojnë ndikime negative, t'u përshtaten ndryshimeve dhe për të iniciuar një proces të rimëkëmbjes nga efektet e rrezikut, dhe atë në kohë dhe në mënyrë efektive, nëpërmjet ruajtjes dhe rinovim të strukturave dhe funksioneve të tyre bazë. (Rregullore për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin i menaxhimit të krizave të cilëve u dorëzohet ekstrakt nga vlerësimi, 128/23, neni 2, paragrafi 1, pika 8)

Cenueshmëria është prania e karakteristikave të veçanta, specifkave dhe rrethanave të individit, komunitetit, sistemeve ose objekteve, që i bëjnë ata të ndjeshëm ndaj ndikimeve negative dhe efekteve dëmtuese të rrezikut të caktuar. (Rregullore për metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet dhe rreziqet, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin i menaxhimit të krizave të cilëve u dorëzohet ekstrakt nga vlerësimi, 128/23, neni 2, paragrafi 1, pika 3)

Menaxhimi i Rrezikut nga Katastrofat (ang. Disaster Risk Governance) përbëhet nga sistemi i institucioneve, mekanizmave, politikave dhe kornizave ligjore dhe aranzhimeve të tjera për drejtimin, koordinimin dhe monitorimin e uljes të rrezikut nga katastrofat dhe fushat e politikave përkatëse. (UNDRR, <https://tinyurl.com/yvrzjycm>)

Mundësi rreziku është një kombinim i disa faktorëve të ndërvarur që ndikojnë në probabilitetin, një rrezik i caktuar të kthehet në një aksident ose katastrofë dhe të realizohen pasojat e tij negative. (Rregullore për

metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të kërcënimit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin i menaxhimit të krizave të cilëve u dorëzohet ekstrakt nga vlerësimi, 128/23, neni 2, paragrafi 1, pika 1)

Shpëtimi nënkupton ndërmarrjen e masave, aktiveve dhe procedurave konkrete për mbrojtjen e njerëzve, të cilëve u rrezikohet jeta apo shëndeti, kafshëve, bimëve, pronave dhe trashëgimisë kulturore nga pasojat e fatkeqësive natyrore dhe aksidenteve të tjera. Ligji për Mbrojtje dhe Shpëtim – Teksti redaktues i konsoliduar, neni 2, paragrafi 1, pika 5)

Menaxhimi me kriza është një kompleks i masave dhe aktiviteteve të marra, me karakter parandalues dhe reagues, me të cilin institucionet kompetente në shtet përpiqen që të eliminojnë të gjitha burimet e kërcënimeve për sigurinë e qytetarëve ose të reduktojnë efektin e tyre në kufij të tolerueshëm. (Vladimir Petrevski, Vladimir Kuculovski. *Sistemi për Menaxhim me Kriza: Manual për Qytetarët*. UNDP. 2010)

Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat (ang. Disaster Risk Management) është zbatimi i politikave dhe strategjive për t'u mbrojtur kundër rreziqeve të reja dhe katastrofave, për të zvogëluar rrezikun ekzistues të katastrofave dhe për të menaxhuar rrezikun e mbetur, duke kontribuar në rezistencën dhe uljen e humbjeve nga katastrofat. (UNDRR, <https://www.undrr.org/terminology/disaster-risk-management>)

Shtojca 2 – PARLAMENTET DHE ULJA E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT NË NIVEL GLOBAL (MË SHUMË INFORMACIONE MBI MEKANIZMAT GLOBAL)

1. Korniza nga Sendai për uljen e Rrezikut nga Katastrofat 2015 – 2030

Korniza nga Sendai është një kornizë globale për uljen e rrezikut nga katastrofat, e miratuar në Konferencën e Tretë Botërore të OKB-së për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat, e mbajtur në Sendai, Japoni, në mars të vitit 2015. Qëllimi kryesor është ulja thelbësore e rrezikut nga katastrofat dhe humbja e jetëve, mjeteve për jetesë dhe shëndet, të mirat ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve, komuniteteve dhe shteteve. Përveç kësaj, vendoset një themel modern për zhvillim rezistent të vendeve dhe territoreve në nivel global, përmes një ndryshimi të paradigmes nga *menaxhimi me katastrofat* ndaj *menaxhimit me rreziqet nga katastrofat*, të rreziqeve ekzistuese dhe të ardhshme, që çon në ndërtimin e rezistencës, si një qëllim thelbësor që duhet arritur deri në vitin 2030. Ajo ka shtatë qëllime dhe katër prioritete për veprim, që kontribuojnë në parandalimin e rreziqeve të reja dhe uljen e rreziqeve ekzistuese, duke përfshirë uljen e rrezikut nga katastrofat në të gjithë sektorët, programet dhe politikat e zhvillimit. Edhe pse është një marrëveshje

vullnetare, jo detyruese, ajo kërkon angazhimin e tërë shoqërisë, me ç'rast qeveritë do të kenë një rol parësor në uljen e rrezikut nga katastrofat.⁵³

Siç u theksua më lart, **Korniza nga Sendai për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat 2015 – 2030** ka një rol të rëndësishëm në përfshirjen e parlamenteve në uljen e rrezikut nga katastrofat në nivel global. *“Parlamentet dhe deputetët janë të pozicionuar në mënyrë unike për të katalizuar, miratuar dhe mbikëqyrur ligjet dhe politikat për të ulur rrezikun nga katastrofat dhe ndikimin e tyre në nivel lokal. Korniza nga Sendai u bën thirrje, në mënyrë eksplicite parlamentarëve, të miratojnë ose të ndryshojnë legjislacionin ekzistues për uljen e rreziqeve nga katastrofat, të ndajnë buxhete për këtë qëllim dhe t'i mbajnë qeveritë përgjegjëse për mbrojtjen e publikut.”*⁵⁴ Në këtë kontekst, dhe me synimin për të përmirësuar kontributin në uljen e rreziqeve, parlamentarët gjatë *Rishikimit afatmesëm të realizimit të objektivave të Kornizës nga Sendai nga maji i vitit 2023*⁵⁵ thirrën në nevojën për të hartuar një udhërrëfyes për sektorët financiarë për atë se si të përfshihet rreziku sistemor, të ndërtohen kapacitetet e vendimmarrësve për uljen e rrezikut nga katastrofat, të krijohen komisione parlamentare për qëllime të uljes së rrezikut apo të krijohen grupe pune, të përmirësohet legjislacioni për të rritur përgjegjësinë e korporatave në investim të energjisë së rinovueshme në raport me lëndët fosile djegëse dhe për të përgatitur dhe ofruar raporte të qëndrueshme financiare, si dhe për të mbledhur dhe ndarë të dhëna të caktuara në kohën e duhur për marrjen e vendimeve të bazuara në rrezik.

2. Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë plane se si të arrihet një e ardhme më e mirë, më e qëndrueshme dhe rezistente për të gjithë. Me gjithsej 17 qëllime, 169 nën-qëllime dhe 230 tregues, OZHQ-fokusohen në tri fusha kryesore: (i) zhdukja e varfërisë; (ii) mbrojtja e planetit nga degradimi, duke siguruar që progresi ekonomik, social dhe teknologjik të ndodhë në harmoni me natyrën; dhe (iii) promovimi i paqes universale dhe shoqërive të drejta dhe gjithëpërfshirëse.

“Në këtë mënyrë, arritja e çdonjërit prej 17 qëllimeve mund të përmirësojë qëndrueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara për t'i bërë ballë katastrofave.”⁵⁶ Aktivitetet klimatike dhe e ulja e rreziqeve nga katastrofat janë çështje ndërsektoriale, të cilat përmenden në mënyrë eksplicite në **OZHQ 13**⁵⁷ për përballim me ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre dhe **OZHQ 11**⁵⁸ për qytete gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme.

Këto dy qëllime janë gjithashtu të rëndësishme për përfshirjen e kufizimit në uljen e rrezikut nga katastrofat, domethënë, **OZHQ 11** “identifikon gjithashtu popullatat në rrezik, duke përfshirë gratë, fëmijët, të moshuarit

⁵³ Popovski, Vasko. Një studim mbi politikat publike për përfshirjen e kufizimeve në uljen e rrezikut nga katastrofat në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. UNPRPD MPFT, UNDP. 2023. faqe. 7. Në dispozicion në: <https://shorturl.at/gxBU2>

⁵⁴ <https://tinyurl.com/y2wvbmah>

⁵⁵ <https://tinyurl.com/yr3y9fca>

⁵⁶ Global Facility for Disaster Reduction and Recovery. *Disability Inclusion in Disaster Risk Management Promising Practices and Opportunities for Enhanced Engagement*. GFDRR. 2017. faqe.24. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3mwta9z6>

⁵⁷ <https://sdgs.un.org/goals/goal13>

⁵⁸ <https://sdgs.un.org/goals/goal11>

dhe personat me aftësi të kufizuara, dhe **OZHQ 13** gjithashtu promovon ndërtimin e kapaciteteve për ndryshime efektive klimatike – planifikimi dhe menaxhimi i ndërlidhur që përfshin gratë, të rinjtë dhe komunitetet lokale dhe të marginalizuara – të gjitha këto do të përfshinin edhe personat me aftësi të kufizuara⁵⁹. Përveç kësaj, ato kontribuojnë edhe në arritjen e shumë qëllimeve të tjera.⁶⁰

Parlamentet kanë një rol të rëndësishëm në realizimin e **Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030**⁶¹ përmes angazhimit sistematik të deputetëve në përpjekjet nacionale për lokalizimin e qëllimeve globale në praktikën në nivel nacional, zbatimin e tyre dhe monitorimin e realizimit. Për shembull, roli parësor i parlamenteve shihet në aspektet e mëposhtme të kompetencave të tyre⁶²:

- *miratimi i ligjeve* (rishikimi i kornizës ekzistuese ose miratimi i një kornize të re politikash dhe kornize ligjore është i nevojshëm për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm), *buxhetimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm* (është veçanërisht e rëndësishme përfshirja e parlamentarëve në procesin e miratimit të buxhetit vjetor, nga zhvillimi përmes miratimit deri te mbikëqyrja, duke siguruar që askush të mos mbetet jashtë programeve buxhetore);
- *mbikëqyrja e politikave për zhvillim të qëndrueshëm* (parlamentarët kanë për obligim të mbikëqyrin zbatimin e politikave dhe masave për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, ku ata mund të sigurojnë llogaridhënien e pushtetit ekzekutiv përmes mjeteve të ndryshme, duke përfshirë legjislacionin dhe një sërë aktivitete të vazhdueshme mbikëqyrëse);
- *përfaqësimi i interesave të qytetarëve* (parlamentarët janë përfaqësues të zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe demokratike nga qytetarët dhe ata duhet të sigurojnë që interesat dhe nevojat e qytetarëve të përfshihen në ligjet, politikën dhe praktikën për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm);
- *bashkëpunimi dhe koordinimi me të gjitha palët e interesuara në procesin e arritjes së qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe lokalizim* (me qëllim për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e plotë të të gjithëve, parlamenti duhet të sigurojë që autoritetet dhe subjektet lokale të përfshihen në këtë proces).

Nga ana tjetër, *Objektivi 16 i Zhvillimit të Qëndrueshëm (Paqe, drejtësi dhe Institucione të forta)* është kyç për rolin e parlamenteve në promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, qasje në drejtësi për të gjithë dhe për të ndërtuar institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në këtë drejtim, treguesi 16.7 kërkon që të sigurohet një vendimmarrje e përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, në të cilën marrin pjesë dhe përfaqësohen të gjitha palët.

3. Marrëveshja e Parisit

Marrëveshja e Parisit synon të rrisë ndjeshëm veprimet klimatike dhe të adresojë ndikimet e ndryshimeve klimatike në mënyrë më gjithëpërfshirëse, për t'u mbrojtur zhvillimi dhe për t'u eliminuar varfëria. Në veçanti, ka për qëllim të ulë ndjeshëm rreziqet dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe të nxisë qëndrueshmërinë klimatike.

⁵⁹ Global Facility for Disaster Reduction and Recovery. *Disability Inclusion in Disaster Risk Management Promising Practices and Opportunities for Enhanced Engagement*. GFDRR. 2017. faqe.24. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3mwta9z6>

⁶⁰ Popovski, Vasko. *Një studim mbi politikën publike për përfshirjen e kufizuar në uljen e rreziqeve nga katastrofat në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut*. UNPRPD MPFT, UNDP. 2023. faqe. 8. Në dispozicion në: <https://shorturl.at/gxBU2>

⁶¹ <https://northmacedonia.un.org/mk/sdgs>

⁶² <https://agora-parl.org/resources/aoe/sdgs-and-role-parliaments>

“Me rëndësi në këtë kontekst është njohja në preambulë se ndryshimet klimatike janë një “shqetësim i njerëzimit” dhe se në marrjen e masave për ndryshimet klimatike, palët duhet të marrin parasysh gjithashtu detyrimet e tyre në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të qytetarëve në situata të cenueshme, duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara”.⁶³ Nenet 7 dhe 8 fokusohen në mënyrë eksplicite në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe uljen e rrezikut nga katastrofat. Konkretisht, neni 7.1 i referohet përmirësimit të kapaciteteve për përshtatje, forcimit të rezistencës dhe zvogëlimit të cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, ndërsa neni 8.1 i referohet parandalimit, minimizimit dhe trajtimit të humbjeve dhe dëmeve që lidhen me efektet negative të ndryshimeve klimatike. Në veçanti, neni 8 përcakton “qëllimi global për përshtatjen është të forcojë kapacitetin adaptues, të forcojë rezistencën dhe të ulë cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm”⁶⁴ Prandaj, fushat e bashkëpunimit dhe përmirësimit të mirëkuptimit, veprimi dhe mbështetja mund të përfshijnë sistemet për paralajmërim të hershëm; gatishmëri për raste emergjente; ngjarjet me fillim të ngadaltë; ngjarje që mund të përfshijnë humbje dhe dëme të riparueshme dhe të përherëshme; vlerësim dhe menaxhim gjithëpërfshirës të rrezikut; kapacitete për sigurim të rrezikut, grupimi i rreziqeve klimatike dhe zgjidhje të tjera për sigurim; humbje joekonomike; dhe rezistencë të komuniteteve, mjeteve për jetesë dhe ekosistemeve. Këto fusha bashkëpunimi dhe lehtësimi lidhen me prioritetet e Kornizës nga Sendai dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm siç tregohet në tabelën më poshtë⁶⁵:

Gjithashtu, parlamentet janë vendimtare në kontekstin e **ndryshimeve klimatike dhe zbatimin e masave për zbutje dhe përshtatje**. “Parlamentarët janë të vendosur në mënyrë unike për të siguruar zbatimin efektiv të Marrëveshjes së Parisit dhe për të rritur ambiciet globale, duke ndikuar në agjendën e tyre nacionale për ndryshimet klimatike.”⁶⁶ Kjo mund të shihet përmes prizmit të kompetencave dhe aktiviteteve të tyre në vijim. Kështu, për shembull, parlamentet e ratifikuan Marrëveshjen e Parisit (në vendin tonë u ratifikua në vitin 2017), e përmirësojnë legjislacionin për ndryshimet klimatike, kontribuojnë për një transparencë dhe përgjegjësi më të madhe në zbatimin e aktiviteteve të lidhura me to në kuadër të funksioneve të tyre mbikëqyrëse. Gjithashtu, parlamentet mund të vendosin mekanizma për të marrë informacione nga qeveritë e tyre në lidhje me rezultatet e konferencës së Palëve (ang. Conference of Parties) të Marrëveshjes së Parisit ose të rishikojnë vlerësimet e gatishmërisë dhe përshtatshmërisë së politikave ose legjislacionit nacional për të zbatuar strategjitë afatgjata klimatike dhe kontributet e përcaktuara në nivel nacional për Marrëveshjen e Parisit.⁶⁷ Gjithashtu, parlamentet kanë detyrimin për pjesëmarrje individuale në trajtimin e ndryshimeve klimatike, duke ndërmarrë masa zbutëse dhe përshtatëse përmes zbatimit të masave strukturore dhe jo-strukturore (shih kornizën e mësipërme).

⁶³ Global Facility for Disaster Reduction and Recovery. *Disability Inclusion in Disaster Risk Management Promising Practices and Opportunities for Enhanced Engagement*. GFDRR. 2017. faqe.27. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/3mwta9z6>

⁶⁴ WB Group. *LIFELINES The Resilient Infrastructure Opportunity*. 2019. faqe.27. Në dispozicion në: <https://tinyurl.com/2bv7hdmd>

⁶⁵ Popovski, Vasko. *Një studim mbi politikat publike për përfshirjen e kufizuar në reduktimin e rrezikut nga katastrofat në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut*. UNPRPD MPFT, UNDP. 2023. faqe. 9-10. Në dispozicion në: <https://shorturl.at/gxBU2>

⁶⁶ <https://www.iied.org/helping-parliamentarians-drive-national-climate-change-policy>

⁶⁷ [https://www.parlAmericas.org/uploads/documents/Global Parliaments and the Paris Agreement ENG.pdf](https://www.parlAmericas.org/uploads/documents/Global%20Parliaments%20and%20the%20Paris%20Agreement%20ENG.pdf)

Një rast i praktikës së mirë

Sekretariati i Unionit Ndërparlamentar ka identifikuar **10 aksione për parlamentet e gjelbra**. Këto veprime mbulojnë tri kategori: institucionalizimi i gjelbërimit të parlamenteve, gjelbërimi i mënyrës së funksionimit të parlamenteve dhe anëtarëve të tyre dhe udhëheqja dhe inkurajimi i një kulture ndryshimi të qëndrueshëm. Rrjedhimisht, këto 10 veprime sigurojnë pika hyrëse konkrete për parlamente më të qëndrueshme që japin shembull kur bëhet fjalë për veprimin klimatik.

Burimi: UNP <https://tinyurl.com/bdcnxt7y>

Një rast i praktikës së mirë

Studimi mbi Përmirësimin e Procedurave për Emergjencë dhe Gatishmëri për Kriza në kuadër të Parlamentit Evropian dhe Institucioneve të BE-së, i porositur nga Departamenti i Politikave të Parlamentit Evropian për të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështjet Kushtetuese me kërkesë të Komitetit për Çështje Kushtetuese (AFCO) analizon pengesat për vendimmarrje efektive demokratike, transparente, në situata emergjente në nivel të BE-së, me fokus të veçantë në Parlamentin Evropian. Ai ofron një pasqyrë sistematike të rolit dhe funksioneve të Parlamentit, si dhe të bashkëpunimit ndërinstucional gjatë situatave të fundit të krizës, dhe përfundon me sugjerime se si të përmirësohet struktura ekzistuese e Parlamentit dhe procedurat e brendshme.

Burimi: Parlamenti Evropian <https://tinyurl.com/2zme6ajx>

Shtojca 3 - KORNIZA NACIONALË PËR ULJEN E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT DHE ROLI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, menaxhimi me uljen e rrezikut nga katastrofat zbatohet në mënyrë gjithëpërfshirëse përmes menaxhimit të krizave dhe sistemeve për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe përmes fushave dhe kompetencave të tjera. Në kontekst të këtij dokumenti, më poshtë janë dhënë kompetencat e Kuvendit në menaxhimin e krizave, mbrojtje dhe shpëtim dhe fusha të tjera.

- **Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2018)**⁶⁸ nuk është parashikuar dispozitë e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rreziqeve nga katastrofat, por neni 125 përcakton se Kuvendi mund të shpall gjendje të jashtëzakonshme përmes procedurës së rregullt në rast fatkeqësie elementare ose epidemisë. Gjendja e jashtëzakonshme ndodh kur ndodhin fatkeqësi të mëdha natyrore ose epidemi. Ekzistimi i gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në një pjesë të saj e përcakton Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës, Qeverisë ose së paku 30 deputetëve. Vendimi për përcaktimin e ekzistimit të gjendjes së jashtëzakonshme merret me shumicën e dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve dhe është i vlefshëm maksimum 30 ditë. Nëse Kuvendi nuk mund të

⁶⁸ <https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf>

mblidhet, Presidenti i Republikës merr vendim për ekzistimin e gjendjes së jashtëzakonshme dhe ia paraqet Kuvendit për konfirmim, sapo të ketë mundësi të mblidhet. Sipas nenit 126, në rast të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin, miraton dekrete me fuqi ligjore. Kompetenca e Qeverisë për nxjerrjen e dekretëve me fuqi ligjore zgjat deri në përfundimin e gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, për çka vendos Kuvendi.

- **Menaxhimi me Kriza** - Sipas nenit 2, paragrafi 1 i Ligjit për Menaxhim me Kriza⁶⁹, Kuvendi është pjesë e institucioneve që përbëjnë Sistemin e Menaxhimit të Krizave. Në kuadër të kompetencave të veta, Kuvendi emëron një anëtar të Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri nga radhët e anëtarëve të Komisionit nga partia më e madhe politike në opozitë për të marrë pjesë në punën e Komitetit Drejtues, i cili është organ i Qeverisë për koordinim dhe menaxhim me sistemin për menaxhim me kriza (neni 13). Grupi për vlerësim ia dorëzon Kuvendit analizat, rekomandimet dhe konkluzionet (neni 19, paragrafi 1). Nga ana tjetër, Kuvendi ka rol edhe në marrjen e vendimit për shpalljen e *gjendjes së krizës*. Qeveria merr vendim për ekzistimin e gjendjes së krizës, përcakton zonën e prekur me gjendjen e krizës dhe në përputhje me rrethanat aktivizon mekanizmat për zgjidhjen e gjendjes së krizës dhe për aktivitetet që lidhen me vendimin brenda 48 orëve gojarisht, dhe një herë në javë me shkrim informon Kuvendin (neni 31, paragrafët 1 dhe 2). Qeveria përgatit dhe i paraqet Kuvendit raport me shkrim jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të aktiviteteve të përcaktuara me vendimin për shpalljen e gjendjes së krizës (neni 31 paragrafi 3). Nëse ka nevojë të zgjasë më shumë se 30 ditë, Qeveria duhet të kërkojë miratimin nga Parlamenti për të zgjatur afatin ose të propozojë shpalljen e gjendjes së luftës ose të gjendjes së jashtëzakonshme. Kuvendi mund të kërkojë raport me gojë ose me shkrim për gjendjen në fushën e menaxhimit të krizave (neni 31, paragrafët 5 dhe 6).
- **Mbrojtje dhe shpëtim** - Sipas nenit 5 të Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim⁷⁰ në zbatimin e mbrojtjes dhe shpëtimit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton Strategjinë Nacionale për Mbrojtje dhe Shpëtim për një periudhë 5 vjeçare, vendos për shumën e fondeve për nevojat e mbrojtjes dhe të shpëtimit dhe shpall ditë të mbrojtjes dhe shpëtimit.
- Nga **fushat e tjera me rëndësi**, në segmentin e shëndetit publik dhe kujdesit shëndetësor nuk janë parashikuar kompetenca të veçanta, ndërsa në mbrojtjen e mjedisit, Kuvendi mund të përgatisë, ndryshojë dhe/ose miratojë strategji, programe dhe plane (Ligji për mjedisin jetësor, neni 5, paragrafi 2, pika 33)⁷¹, Qeveria i paraqet Kuvendit për informim Raportin Vjetor për Cilësinë e Mjedisit Jetësor dhe Raportin Tregues për Mjedisin Jetësor (Ligji për mjedisin, neni 45, paragrafi 3), e shqyrton Strategjinë nacionale për zhvillim të qëndrueshëm (Ligji për mjedisin jetësor, neni 186, paragrafi 2), Komisioni Parlamentar për Mundësi të Barabarta është i përfshirë në promovimin e roleve udhëheqëse të grave për veprimin klimatik⁷² dhe rekomandimet për përmirësimin e zbatimit të propozim Planit të veprimit për përfshirjen e çështjeve gjinore në politikat për ndryshimet klimatike pa një lëndë për një debat publik në Komisionin parlamentar për Mundësi të Barabarta.⁷³ Në kontekst të planifikimit hapësinor, Kuvendi harton Projekt-Planin Hapësinor (Ligji për Urbanizëm, neni 30, paragrafi 1)⁷⁴ dhe miraton Planin Hapësinor brenda gjashtë muajve pas dorëzimit

⁶⁹ Ligji për Menaxhim me Kriza ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 29/2005, 36/2011, 41/2014, 104/2015 и 39/2016)

⁷⁰ Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 36/04, 49/04, 86/08, 124/10, 18/11, 41/14, 129/15, 71/16, 106/16, 83/18, 215/21)

⁷¹ Ligji për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53)/2005)

⁷² <https://tinyurl.com/22sbwcvj>

⁷³ <https://tinyurl.com/5hwuczfk>

⁷⁴ Ligji për planifikim urbanistik (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 32/20)

nga Qeveria (Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Urbanistik - teksti i konsoliduar, neni 41, paragrafët 1 dhe 2), si dhe pranon raportin vjetor për zbatimin e Planit Hapësinor të dorëzuar nga Qeveria (Ligji për zbatimin e Planit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë, neni 7, paragrafi 1).⁷⁵

Shtojca 4 – LIGJET DHE AKTET NËNLIGJORE NGA FUSHA E ULJES SË RREZIQEVE NGA KATASTROFAT

Ligji për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005).

Ligji për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/04, 139/08, 99/09, 149/14, 150/15 dhe 37/16).

Ligji për kujdesin shëndetësor - Teksti i konsoliduar redaktues (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/16).

Ligji për mbrojtje dhe shpëtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 36/04, 49/04, 86/08, 124/10, 18/11, 41/14, 129/15, 71/16, 106/16, 83/18, 215/21).

Ligji për Shëndetin Publik - Teksti i konsoliduar redaktues (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/16).

Ligji për shuarje të zjarrit – Teksti i konsoliduar (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 168 nga viti 21.11.2017).

Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e RMV-së, Nr. 104/19).

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 258/20).

Ligji për menaxhim me kriza ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 29/2005, 36/2011, 41/2014, 104/2015 dhe 215/21).

Ligji për planifikim urbanistik (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 32/20).

Ligji për zbatimin e planit hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, 39/04).

Rregullorja për planifikim urbanistik (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 225/20).

⁷⁵ Ligji për zbatimin e planit hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, 39/04)

Një rast i praktikës së mirë

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e hartimit të Strategjisë së re Nacionale Zhvillimore përmes pjesëmarrjes së dy deputetëve në Këshillin Drejtues shumësektorial të Strategjisë Kombëtare Zhvillimore, pjesëmarrjes së deputetëve në punëtori vizionare, pjesëmarrje aktive në debate me ekspertë dhe informim mbi aktivitetet e realizuara.

Burimi: <https://tinyurl.com/mvj6ss5n> dhe <https://tinyurl.com/2x35w8ux>

Dekreti për Metodologjinë për përgatitjen e vlerësimit të rrezikut për sigurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të gjitha rreziqet, përmbajtjen dhe strukturën e tij, mënyrën e ruajtjes dhe përditësimit, si dhe përcaktimin e subjekteve në sistemin për menaxhim me kriza të cilëve u dorëzohet çertifikatë e plotë nga vlerësimi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 128/23).

Dekreti për zbatimin e masës për mbrojtje dhe shpëtim - evakuim të popullatës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 101/10).

Shtojca 5 – GJETJE DHE REKOMANDIME NGA TAKIMET KONSULTATIVE ME DEPUTETË

Në kuadër të detyrës për përgatitjen e manualit për menaxhim me rreziqe nga katastrofat për deputetët e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në periudhën nga 5 prilli deri më 25 korrik 2023, janë mbajtur takime me përfaqësues të grupeve parlamentare të Aleancës për Shqiptarët, VMRO-DPMNE, Lidhja Demokratike, PDM, BDI dhe LSDM. Rrjedhimisht, janë identifikuar mangësitë ekzistuese dhe janë formuluar rekomandime për periudhën e ardhshme, nga të cilat një pjesë janë inkorporuar në tekstin e manualit, dhe një pjesë mund të zbatohen në ndërhyrjet e mëposhtme të projektit ose përmes punës së Kuvendit.

Mangësitë e identifikuara

- *Deputetët nuk janë të njoftuar mjaftueshëm me aspektet e mbrojtjes dhe shpëtimit në rast të rreziqeve natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu, nuk marrin pjesë në ushtrime për evakuim të shpejtë apo në aktivitete të ngjashme për përballim të krizave dhe katastrofave.*
- *Nuk janë të njoftuar me veprimin e zgjatur të Kuvendit në rast krize apo katastrofe ose me vendin alternativ të punës dhe procedurat e punës.*
- *Nuk janë të njoftuar mjaftueshëm me trendet dhe mekanizmat moderne për ulje e rreziqeve nga katastrofat dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.*
- *Nuk ekziston mundësia për të punuar në një regjim hibrid apo onlajn, gjë që pengon punën e Kuvendit në kushtet e një krize pandemike apo katastrofe tjetër.*
- *Objekti i Kuvendit nuk është i qasshëm mjaftueshëm për personat me aftësi të kufizuara fizike.*
- *Deputetëve nuk u ofrohet mbështetje profesionale për atë se si të sillen me qytetarët dhe grupet e ndryshme të cenuara në rast të krizës apo katastrofës.*
- *Vendimet e miratuara nga Presidentit i Republikës për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme nuk janë konfirmuar nga Kuvendi sapo ka pasur mundësi të mblidhet sipas nenit 125, paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.*
- *Dekretet me fuqi ligjore të miratuara nga Qeveria, sipas nenit 126 të Kushtetutës gjatë kohës së shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në periudhën e përballimit me pandeminë me COVID-19 nuk janë dorëzuar në Kuvend dhe nuk janë vlerësuar.*
- *Pavarësisht kërkesës së deputetëve/grupeve të deputetëve, nuk është mbajtur asnjë seancë mbikëqyrëse për përballimin ndaj pandemisë me COVID-19.*

- Nuk funksionon mjaftueshëm Komisioni për të Drejtat e Njeriut, nën juridiksion të të cilit janë edhe një pjesë e aspekteve të menaxhimit të rreziqeve nga katastrofat dhe gjendjen e krizës.
- Mungojnë protokollet dhe procedurat standarde operative për përballim me kriza.
- Në përgjithësi Kuvendi është i përjashtuar nga proceset kryesore për uljen e rreziqeve nga katastrofat, gjegjësisht për menaxhim me kriza si dhe mbrojtje dhe shpëtim.
- Deputetët nga trupi punues amë, d.m.th. Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri apo përfaqësues të Kuvendit nuk janë të përfshirë në proceset reformuese të sistemit për menaxhim me kriza.
- Materialet për zgjatjen e gjendjes së shpallur të krizës, në mënyrë të pamjaftueshme e elaborojnë nevojën e zgjatjes, pa dhënë detaje të mjaftueshme, të precizohen burimet e nevojshme dhe shpenzimet për angazhimin e tyre, planet për përballimin e krizës etj. Kjo procedurë kuptohet si proforma, gjegjësisht se Kuvendi duhet ta votojë Vendimin me kërkesë të Qeverisë, pa elaborim apo diskutim paraprak të detajuar. Gjithashtu u theksua edhe aspekti i kohëzgjatjes së gjendjes së shpallur të krizës, d.m.th. zgjatet edhe për gjashtë muaj pa u parashikuar ky afat me vendim ligjor ose nënligjor.
- Llogaridhënia e Qeverisë dhe institucioneve shtetërore për sa i përket resurseve për përballimin e krizave dhe katastrofave është e pamjaftueshme dhe kjo karakterizohet me informacione të pamjaftueshme për procedurat, burimet e angazhuara dhe mjetet e shpenzuara.
- Mekanizmat për mbikëqyrje që ka Kuvendi, për trajtimin e situatave të krizës dhe katastrofave, nuk shfrytëzohen mjaftueshëm. Edhe në rast kur kërkohet një seancë mbikëqyrëse, shpesh për arsye politike, ajo nuk merr mbështetjen e mjaftueshme nga një numër më i madh i deputetëve nga parti të ndryshme politike. Diskutimet/vizitat në terren nuk përdoren si mjet, si për shkak të mungesës së burimeve për zbatim, ashtu edhe për mungesë interesi.
- Pyetjet e deputetëve janë mekanizmi më efektiv mbikëqyrës deri më tani, por ato janë të kufizuara dhe nuk mund të përdoren sa duhet, d.m.th. aq sa ka interes nga ana e deputetëve.
- Komisionet anketuese funksionojnë rëndë, dhe shpesh bllokohen për interesa të ndryshme partiake, pavarësisht kësaj mungojnë rregullore të punës dhe buxheti i përcaktuar.
- Procedura buxhetore nuk është mjaft e qartë dhe e kuptueshme, veçanërisht për programet individuale, pasi që analitika gjashtëshifrore nuk paraqitet qartë, por vetëm ajo treshifrore.
- Burimet e Kuvendit për një rol më të madh të deputetëve në menaxhimin e rrezikut nga katastrofat janë të pamjaftueshme.
- Edukimi i pamjaftueshëm i asistentëve të deputetëve, shërbimeve parlamentare dhe Institutit Parlamentar në fushën e menaxhimit të rrezikut nga katastrofat.
- Mësimet e nxjerra, praktikat e mira dhe vlerësimet e ngjarjeve të kaluara nuk janë të kodifikuara si bazë për përmirësimin e sistemit.
- Kuvendi nuk është i përfshirë mjaftueshëm në punën e Platformës Nacionale për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat si një forum nacional për rrjetëzimin e të gjitha institucioneve dhe palëve të interesuara për avancimin e menaxhimit të rrezikut nga katastrofat.
- Pjesëmarrje më të madhe në fushën e grupeve joformale.

Rekomandime për periudhën e ardhshme

- Pjesëmarrja aktive në edukimin për mbrojtje dhe shpëtim, organizim dhe pjesëmarrje në ushtrime trajnuese dhe në aktivitete për mbrojtje dhe shpëtim.
- Miratimi i Planit për veprim të zgjatur të Kuvendit dhe njohja e deputetëve me të.

- Sensibilizimi dhe edukimi i deputetëve dhe shërbimeve rreth mekanizmave dhe kornizave globale dhe nacionale për uljen e rrezikut nga fatkeqësitë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, për zhvillim të qëndrueshëm dhe rezistent.
- Ofrimi i mbështetjes profesionale për deputetët se si të sillen me qytetarët dhe grupet e ndryshme të cënueshme në rast krize apo katastrofe.
- Rregullimi i procedurës për zgjatjen e gjendjes së shpallur të krizës dhe përcaktimi i afateve.
- Përdorimi aktiv i mekanizmit mbikëqyrës, veçanërisht për përdorimin e fondeve publike dhe më pas miratimi i konkluzioneve me qëllim përmirësimin e situatës në fushat tematike.
- Përmirësimi i edukimit dhe njohurive buxhetore të deputetëve me synimin të shqyrtimit të kornizave ekzistuese buxhetore dhe përmirësimin e investimeve në politika dhe praktika parandaluese.
- Për shkak të rëndësisë strategjike të procesit të reformës në sistemin e menaxhimit me kriza, është e nevojshme të hapet një debat në Kuvend.
- Kodifikimi i mësimave të nxjerra, praktikave të mira dhe miratimi i vlerësimeve të menaxhimit të krizave dhe katastrofave.
- Mbajtja e seancës tematike të Kuvendit me qëllim të shënimit të 13 Tetorit – Ditës Ndërkombëtare për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat. Këtë vit tema është “Lufta kundër pabarazisë për një të ardhme rezistente”.
- Rrjetëzimi i parlamenteve nga Evropa Juglindore në segmentin e uljes së rrezikut nga katastrofat dhe krijimi i mundshëm gjegjësisht qendrave/komisioneve për përsosmëri, ku çdo parlament do të mbulonte një fushë specifike të menaxhimit të rrezikut nga katastrofat.

BIBLIOGRAFI

1. Vasko Popovski. Një studim mbi politikat publike për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. UNPRPD MPFT, UNDP. 2023.
2. Global Facility for Disaster Reduction and Recovery. *Disability Inclusion in Disaster Risk Management Promising Practices and Opportunities for Enhanced Engagement*. GFDRR. 2017.
3. IPU, UNDRR. *Disaster Risk Reduction to achieve the Sustainable Development Goals A toolkit for parliamentarians*. IPU, UNDRR. 2021.
4. Magdalena Lembovska, Zoran Neçev, Jim Ruff. “Menaxhimi i krizës si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut”. Instituti Nacional Demokratik. 2021.
5. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. 4 Plani nacional për ndryshimet klimatike. 2023.
6. NDI. Procesi i dëgjimeve publike. Udhëzues për deputetët dhe shërbimin parlamentar. 2011.
7. NDI USAID. IRI. Roli i parlamentit në politikën fiskale gjatë gjendjes së jashtëzakonshme: Mësimet e nxjerra për planifikimin e gjendjes së jashtëzakonshme.
8. ParlAmericas. UNDRR. *Parliamentary Protocol for Disaster Risk Reduction and Climate Change Adaptation*. 2019.
9. UNDRR. Korniza nga Sendai për ndikim të reziqeve nga katastrofat 2015 – 2030. 2015.
10. WB Group. *LIFELINES The Resilient Infrastructure Opportunity*. 2019.
11. Vladimir Gjurgjevik. Climate projection report changes and for changes in the extreme climate events in the Republic of North Macedonia. UNDP. 2020.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Implementuar nga:

